

albiSLAM

faqe 4

Editoriali

faqe 5-14

Aktuale

Loja me fjalë në Lindjen e Mesme
Vrojtime politike
Të drejtat e njerëzve në Gjermani?!

faqe 15-27

Artikuj

Arabët hajdutë?!
Kriteret e të mençurve
Dhe njerëzve foluni fjalë të mira (3/3)
Testi provues

faqe 28-41

Tema

Ndërmjetësimi - tek Allahu dhe te njerëzit
Biseda gjatë namazit
Deumetul xhendel – ngjarja që ktheu krenarinë e Medinës

faqe 42-54

Gruaja dhe familja

Si ta përfitojmë dashurinë e bashkëshortes
Dy jetimët
Mes Mehmed Fatihit dhe Spiderman-it
Kujto...

faqe 56-58

Pyetje përgjigje

Mbajtja dhe shitblerja e qenve

faqe 59-62

Ilmihalli

Përshkrimi i momenteve të Ahiretit

faqe 63-65

Libri

Prezantim i librit “Studime dhe Fetva”

faqe 66

Letra

Allahun e falënderojmë, pagja dhe bekimi qofshin mbi Muhamedin, familjen, shokët dhe gjithë ata që ecin hapave të tyre sinqerisht deri në ditën e Kiametit.

Të nderuar!

Takohemi në këtë numër të Albislamit në petkun e ri, i cili do t'u freskon me risitë në redaksi dhe risitë në përmbajtje.

Kjo që ju ofrojmë është një mund me të cilin janë bashkuar hoxhallarët dhe thirrësit nga trojet shqiptare dhe mendojmë se kjo është një fryt mjaft i rëndësishëm dhe i vlefshëm për popullin tonë të dashur mysliman shqiptar.

Shkrimet e Albislamit synojnë ofrimin e Islamit burimor dhe shkencor dhe është një kontribut modest për të zgjidhur dilemat dhe kokëçarjet me të cilat ballafaqohen myslimanët në përgjithësi dhe rinia islame shqiptare në veçanti.

Islami sot ballafaqohet me lloj-lloj akuzash dhe nga kënde dhe prizma të ndryshme, andaj detyrë e hoxhallarëve dhe thirrësve është që tua tregojnë muslimanëve Islamit të kulluar nga çdo njollë dhe tu japin përgjigje dilemave që manifestohen herë pas here në media dhe oda rreth rikthimit të fesë në jetën shoqërore të shqiptarëve.

Kur vijnë këto akuza nga jashtë, nga qarqe të njohura për armiqësi ndaj shqiptarëve çështja është e qartë, mirëpo kur na vijnë prej brenda, nga njerëz që në një far mënyre konsiderohen lider të popullit, apo të një pjese të popullit, të cilët janë mysliman dhe ndihen krenar për këtë gjë, atëherë kjo dhimbje shtohet dhe bëhet e zhurmshme.

Sot disa njerëz nuk kanë guximin të akuzojnë drejtpërsëdrejti Islamit, andaj përdorin akuzat ndaj ekstremizmit apo fundamentalizmit islamik, thua se vetëm tek Islami paska dukuri dhe fenomene të këtilla, duke i heshtur izmat e tilla që gjenden përbrenda shtresave të caktuara tek shqiptarët dhe në fqinjësinë tonë.

Si duket qëllimi i këtyre njerëzve është provokimi i situatës dhe inicimi i trazirave në mendjen e popullit tanë, duke luajtur me ndjenjat e muslimanëve, sidomos rinisë, dhe të nxjerrin zgjimin Islam nga diskursi i tyre i qetë dhe ofërtdhënës për popullin tonë që ta nxjerr nga ky udhëkryq në të cilin ka ardhur.

Sidoqoftë, myslimanët, sidomos të rinjtë, duhet të kuptojnë se kështu janë sjellë paritë e popujve injorantë ndaj pejgamberëve, të cilët njerëzit i kanë thirrur në besim, vepra të mira dhe moral, kurse përgjigjja e pejgamberëve ka qenë: duroni, përhapeni të mirën dhe njerëzve thoni fjalë të mira!

Në emër të redaksisë: Bekir HALIMI

Loja me fjalë në Lindjen e Mesme

Gazetaria e luftës

Shkruan: Joris LUYENDIJK

Nëse dëshirojmë të kuptojmë pse, ku, kur, kush dhe si, duhet të dëgjojmë të gjitha palët rreth "pse"- së, duke u kujdesur që të bëjmë ndarje mes realitetit dhe mendimeve... A nuk bëhet kështu gazetaria cilësore?

A nuk premtojnë objektivitet reklammat e CNN, Fox, ose Jazeera nën parullën "ne u emetojmë ndodhitë, kurse ju vendosni"?

Edhe pse unë pas punës si reporter për pesë vite nga Lindja e Mesme kthehem me një rezymë pesimiste: gazetarët perëndimor nuk kanë mundësi që të përshkruajnë me precizitet e mos të flasim për objektivitet botën arabe dhe Lindjen e Mesme. Edhe kur i respektojnë rregullat e punës së gazetarisë tekstualisht, ata ofrojnë përshkrim të shëmtuar dhe të errësuar të thellë të rajonit.

Problemi kryesor ka të bëjë me frazat që përdoren: frazat që i përdorin gazetarët nuk domethënë asgjë për evropianët ose amerikanët, ose kuptohen në mënyrë të ndryshme ose deformohen shumë lehtë.

Shembujt më të mirë të këtyre frazave "të panjohura" nga opinioni perëndimor, domethënë se njerëzit i përdorin pa i shijuar ato, janë "okupacioni" dhe "diktatura". Mosnjohja e



natyrës së diktatorizmit nuk ka të bëjë vetëm me intelektualët dhe opinionin e gjerë. Gjatë punës time si reporter disa herë qortohesha nga kryeredaktori: pse je vonuar kaq për të marrë vizën për hyrje në Irak gjatë sundimit të Sadam Husejnit? Pse akoma nuk ke arritur në Libi? Pse nuk të japin vizë? Insisto tek ata! Një gazetar i njohur në çështjet e analizave kërkoi prej meje që të gjej mënyrë për të kontaktuar me sigurimin e Jordanisë. Kurse kontabilisti i gazetës kërkonte prej meje faturat fiskale nga personat që u kam dhënë rryshfet gjatë vizitës time në Irak në kohën e Sadam Husejnit.

Të gjithë këta, kryeredaktori, kontabilisti dhe analisti, i përcillnin ndodhitë nga afër, i lexonin gazetën dhe

përcillnin televizorin. Mirëpo këto gazeta dhe stacione televizive si ka mundësi ta sqarojnë diktaturën në formën e tij të vërtetë?

Librin që botova në verën e vitit të kaluar ka të bëjë rreth kësaj teme: frika, dyshimi, shpërlajra e trurit, abuzimet, shkatërrimet e qëllimta të resurseve të veçanta të çdo njeriu dhe të fisnikërisë personale.

Botuesi u nxe personalisht dhe e lexoi disa herë librin. U kthye nga panairi i librit në Frankfurt edhe më i nxehur. Kishte folur për librin tim me një koleg timin egjiptian, i cili u angazhua rreth kësaj teme.

Depërtimi im në botën arabe ishte afër! Mbeti i shndërritshëm deri në ditën që ia sqarova kontradiktat në shprehje: a do të lejojë ndonjë diktaturë botimin e një libri që analizon natyrën e urryer të vet diktaturës? Edhe pse i lexoi njëqind faqet e rezervuara për kulturën e frikës, në të cilën mbështeten shtetet policore, domethënia e diktaturës mbeti e zhveshur për lexuesin perëndimor.

Shprehja "okupacion" a është boshe për lexuesit dhe spektatorët perëndimor? Ky boshllëk është ajo që komenton shkakun pse shtojmë (perëndimi) presionin ndaj qeverisë palestineze që të argumentojë se është duke "bërë atë që kërkohet kundër dhunës", kurse asnjëherë nuk kërkohet nga zëdhënësi i qeverisë izraelite pse "nuk bëjnë atë që duhet për të përfunduar okupacionin".

S'ka dyshim se qytetari në perëndim e kupton kërcënimin e trishtueshëm të terrorizmit, duke filluar nga përgjegjësit e të djathtës, të cilin pa ndalë e përmendin. Mirëpo kush ia sqaron publikut perëndimor terroristin e fshehur pas vellos së "okupacionit"?

Nëse i shikojmë statistikat të cilit do vit do të shohim se numri i viktimave civil palestinez që kanë rënë nga veprimtaria e okupimit izraelit është së paku tre fish më i madh se numri i viktimave civil izraelit, të cilët janë vrarë nga sulmet. Mirëpo reporterët dhe komentuesit perëndimor flasin për "aksionet vetëvrasëse të përgjakura" dhe aspak nuk e përmendin "okupimin e përgjakshëm".

Nëse skandalet e përditshme të okupacionit në masë të madhe mbeten larg syve, atëherë "informatat" që vijnë nga "diktatoritë" vijnë në gazeta dhe stacionet televizive perëndimore. Këtu

lind problemi i dytë: gazetaret kur i përshkruajnë ndodhitë, ata përdorin shprehjet që janë të veçanta për demokracitë, sikurse janë: "parlamenti", "gjykatësi", shprehjet "kryetari Mubarek", në vend se "diktatori Mubarek", flasin për "Partinë demokratike kom-

bëtare" edhe pse aty s'ka aspak demokraci e as elemente të një partie. Përmendin profesorë universitarë nga bota arabe, mirëpo harrojnë të shtojnë se ai kontrollohet nga sigurimi shtetëror. Kur dalin në ekranet televizive disa djelmosha të hidhëruar duke djegur flamurin kanadez në një shtet policor, këtë e emërtojnë "protestë" dhe jo aktivitet reklamues.

Ajo që të sjell në mëdyshje është fakti se reporterët që gjenden në Lindjen e Mesme e dinë shumë mirë se çka domethënë okupacioni dhe diktatura. Ata jetojnë dhe punojnë në vendet arabe, në tokën e okupuar palestineze, kanë miq, kolegë dhe farefis, mirëpo në raste nevojë nuk mund të kërkohet asnjë ndihmë ligjore. Ata miq, kolegë dhe farefisi nuk janë qytetar por janë

Pse çifuti i cili kërkon një tokë, të cilën ia ka dhënë Zoti nuk quhet "nacionalist ekstremist" kurse një musliman që e përdorë të njëjtën logjikë cilësohet si "fundamentalist"?

Nëse i shikojmë statistikak të cilit do vit do të shohim se numri i viktimave civil palestinez që kanë rënë nga veprimtaria e okupimit izraelit është së paku tre fish më i madh se numri i viktimave civil izraelit, të cilët janë vrarë nga sulmet

pasues, të zhveshur nga çdo mbrojtje dhe ata e dinë shumë mirë këtë. Mirëpo si ta dijë këtë gjë publiku perëndimor, si ta dijë praktikisht se si punon një sistem i këtillë? Sidomos kur njësitë gjuhësore të përdorura japin kuptimin se shtetet policore dhe demokracitë, përafërsisht, punojnë sipas të njëjtës metodë, kanë parlament, kryetar dhe mbi këtë "zgjedhje!?"

Disa fjalë nuk kanë domethënie të madhe për një qytetar të rëndomtë në perëndim, kurse disa tjera kanë domethënie tjetër. Janë fjalë me të cilat luhet, nëse i kalojmë disa çaste para stacioneve televizive satelitore do të na mjaftojnë për të sjellë argument për këtë gjë. A themi "Izraeli" apo "Shteti Zionist" apo "Palestina e okupuar"? "Intifada", "Holokausti i ri", "rezistenca për pavarësi"? Kjo copë toke është "kontestuese", ose "okupuar" ose "jepet" ose "kthehet"? A konsiderohet "koncesion" nëse Izraeli zbaton një detyrim që lind nga një marrëveshje, të cilën e ka nënshkruar më herët? A ka "negociata" mes palestinezëve dhe izraelitëve. Nëse kjo është e saktë, cila është hapësira për manovra e palestinezëve, kur e dimë se "negociatat" kanë kuptimin e koncesioneve reciproke mes dy palëve të përngjashme?

Gjatë punës time si reporter disa herë qortohesha nga kryeredaktori: pse je vonuar kaq për të marrë vizën për hyrje në Irak gjatë sundimit të Sadam Husejnit? Pse akoma nuk ke arritur në Libi? Pse nuk të japin vizë? Insisto tek ata!

Nuk ka këtu fjalë të paanshme. Pra, në cilat njësi gjuhësore duhet të mbështetemi? Nuk është lehtë të shkruash një telegram gazetaresk të llojit: "Sot në Jahuda dhe Samira /në tokat palestineze/ në tokat e okupuara palestineze/ në tokat kontestuese/ në tokat e çliruara/ tre palestinez të pafajshëm/ terroristë mysliman u vranë preventivisht/ u vranë egërsisht/ u vranë nga armiku sionist/ nga forcat e okupatorit izraelit/ nga forcat mbrojtëse të ushtrisë izraelite". Apo rreth Irakut: sot, forcat sio-kryqtare/ okupuese amerikane/ aleancës sulmuan bazat e rezistencës islame/ terroristëve/ qelive terroriste".

Kultura perëndimore është optimiste. Kur përcakton ndonjë problem njëkohësisht prej teje kërkohet zgjidhja me këtë përcaktim.

Mirëpo si të dalim nga kjo kënetë gjuhësore përpos se konfirmim, ndoshta me çiltërsi më të madhe, me anim dhe vetkontroll, nga e cila nuk mund të ikim në asnjë veprim gazetaresk, ndalimi i mashtrimit nga parrulat konsumatoreske.

Ne i emetojmë ndodhitë, kurse ju vendosni. Mirë. Mirëpo ne vendosim se çka do të shihni dhe si do t'i shihni.

Fatmirësisht ka mbetur edhe kategoria e fundit e shprehjeve, të cilat media perëndimore mund t'ua jep hakun në mënyrë më të mirë.

Pse çifuti i cili kërkon një tokë, të cilën ia ka dhënë Zoti nuk quhet "nacionalist ekstremist" kurse një musliman që e përdorë të njëjtën logjikë cilësohet si "fundamentalist"?

Një diktator arab që zgjedh politikë që dallon nga politika perëndimore

emërtohet "armiqtësor ndaj perëndimit" mirëpo nuk jepet i njëjti emërtim në drejtimin e kundërt?

A mund të parafytyrojmë një lider amerikan të cilësohet "ekstremist në armiqtësinë e tij kundër arabëve"?

Një përgjegjës izraelit i cili vetëm në dhunë beson për ta mbrojtur popullin e vet është prej "shqiponjave", mirëpo a kemi dëgjuar për "shqiponjat" e palestinezëve?

Assesi, ata janë ekstremist dhe terrorist. Përgjegjësit izraelit që besojnë në bisedime janë prej "pëllumbave", kurse palestinezi që zgjedh të njëjtën rrugë është "i moderuar", që domethënë se edhe pse dhuna ka zërë vend në zemrën e tij, ky palestinez, i falem Zotit, ka ndryshuar natyrën e tij origjinale. Përderisa Hamasi e "urren" Izraelin, kurse asnjë parti apo lider izraelit "urren" palestinezët, madje edhe kur këta lider përdorin ministrinë e tyre për të kërkuar deportimin e palestinezëve, përpos nëse kjo gjë ka të bëjë me "spastrimin etnik", apo "deportimin e dhunshëm" apo "transferimin"?

Autori është gazetar holandez, autor i librit "Gjysmë njeriu. Foto nga Lindja e Mesme", në gjuhën holandeze. Botoi Shtëpia botuese "Podium". Viti 2006. Janë shitur 600 mijë kopje në Holandë.

Marrë nga: Le Mond Diplomatique, verzioni arabisht, për Mars, 2007.

Përktheu: Bekir HALIMI

Vrojtime politike

Shkruan: Dr. Muhamed el-Abdeh

(I) Epidemia e korrupsionit

Të dhënat e fundit, që tregojnë atë çka po ndodh brendapërbrenda shtetit sionist në gjirin e Palestinës, dëftojnë qartas ndryjen e thellë në të cilën janë zhytur qoftë kreu i shtetit, qoftë kryeministri, qoftë disa ministra. Të gjithë gjenden nën akuzën e përfshirjes në hallkat e korrupsionit, si dhe në skandale morale. Tepër i çuditur, Jehuda Jehari shkruan në kolonat e "Bedijut Ahrenut": "Çfarë po i ngjet vallë Izraelit? Është e pamundur të gjejmë një njeri të shëndoshë, të cilit mund t'i besojmë ofiqet më të larta shtetërore; shkurt, një njeri mbi të cilin të mos rëndojë asnjë dyshim. Ai çka kërkojmë nuk është veçse një njeri i pastër, i cili nuk ujdiset të blejë një shtëpi me çmim fare të ulët dhe pastaj, kinse gabimisht, e detyrojnë ta shesë me çmim më të lartë?!" (Shih: el-Kuds el-Arabi 28/ 2/ 2007).

Kjo gjë më solli ndërmend atë që kishte shkruar gjeniu i historisë islame, Ibën Halduni, teksa parashtron përmes një analize të thellë shkaqet e destabilizimit dhe të dobësimit të mbretërisë së Izraelitëve mbasi dolën nga Egjipti. Në atë kohë, Shami ishte teatër fisesh dhe popujsh të përçarë, të cilët vrisnin shoqi-shoqin, e kjo sëmundje ngjitetëse (përçarja) u mbart edhe tek Izraelitët, të cilët u përçanë egërsisht mes tyre. Që prej atij



çasti, ata, Izraelitët, "nuk do të kishin kurrë më një mbretëri të vazhdueshme, e cila të pranohej si e tillë nga të gjithë, çka zgjati deri në kohët kur ranë nën sundimin e persëve, paskëtaj nën atë të grekëve dhe, së fundmi, nën sundimin romak, gjatë kohës kur zë fill edhe shpërngulja e tyre." (Shih: "El-Mukadime", 2/536).

A mos ndoshta kjo epidemi e korrupsionit në administratë u transferua falë përhapjes së saj në formë miti të çifutët, çka është e pranishme edhe te pjesa dërrmuese e shteteve arabe? A mos ndoshta kjo është një

Rusia është distancuar plotësisht nga politika e butë dhe e paqëndrueshme që Jelcini kish treguar kundrejt Amerikës. Ajo filloi të ballafaqohet dhe t'i pengojë përpjekjet amerikane për depërtim në shtetet islamike, të cilët ishin dikur pjesë e Bashkimit Sovjetik

e mirë nga të mirat e kësaj qeverie (edhe pse të mirat e tyre janë pak) e cila ia ngjiti këtë sëmundje shtetit izraelit!

(2) Amerika dhe disa tipare të ardhmërisë

Politika amerikane po kalon nëpër një zinxhir përplasjesh të mëdha, kurse Bushi po përjeton momentet e tij më kritike në Irak. Shumë zëra janë ngritur fuqishëm dhe i kërkojnë me këmbëngulje Uashingtonit tërheqjen e forcave nga Iraku.

Humbja e Amerikës në Irak nuk është e ngjashme me humbjen e saj në Vietnam; kjo për faktin e thjeshtë se, në Vietnam lëvizte një shtet të madh (Bashkimi Sovjetik), i cili po përkrahte fuqimisht e po u vinte në ndihmë vietnamezëve, ndërkohë që në Irak po lëviz dhe vepron qëndresa e fortë e botës arabe dhe islame; ndonëse pa kurrfarë përkrahjeje nga asnjë shtet, i madh apo i vogël qoftë, dhe pa kurrfarë ndihme nga

jashtë, sërish këto forca do të ngadhënjë dhe do të jenë dështimi i Amerikës. Andaj, a do të jetë ardhmëria e Amerikës e ngjashme me atë të Britanisë pas luftës së kanalit të Suezit, pas të cilës mbeti vetëm një shtet i madh, i cili e kuptoi mirë madhësinë dhe forcën e vet (pretenduese) dhe u tkurr në ishujt e vet në veri-perëndim të Evropës?

Ajo që na e forcon bindjen se Amerika e vitit 2006 nuk është më ajo e pas rënies së Bashkimit Sovjetik janë faktet që shohim përditë, si dhe mënyra se si po ndërrojnë gjërat në parkun e përmbapëm të Shteteve të Bashkuara; fjala është për kontinentin e Amerikës Latine, disa shtete të të cilit filluan të marrin një drejtim krejt tjetër nga ai i Amerikës kapitalist-liberale.

Shkrimtari francez Xhir Kurt thotë: "Për herë të parë në historinë e saj bashkëkohore, demokracitë latine po ndiejnë se janë të lira në gjetjen e rrugëve të tyre të veçanta". Në Venezuelë njerëzit po tregojnë entuziazëm për punë vullnetare, ndërkohë që udhëheqësi i tyre (Çavezi) i ofroi naftën e vendit të tij Kubës me kushtin që kjo e fundit të sjellë grupe mjekësh në Venezuelë. Bolivia, ky shtet i varfër, i refuzoi rrobat e përdorura, të cilat vinin nga Shtetet e Bashkuara. Kryetari i ri i këtij shteti shprehet prerazi: "Duhet ta ndalojmë këtë importim nënçmues, i cili është duke e mbytur industrinë vendore të tekstilit". (Krahaso këtë gjë me botën arabe, e cila po importon rroba të përdorura, ndërkohë që, në të kaluarën, eksportonin kumashin në Evropë!).

Një tjetër ndryshim, që nuk i shkon asfare për josh Amerikës, është edhe roli i ri që po mundohet të marrë mbi vete Rusia, për të treguar se, si shtet i madh që është, edhe ajo ka peshën e saj në zhvillimet politike

botërore. Nuk është aspak e vështirë për t'u kapur pakënaqësia që shfaq Rusia në lidhje si me hegjemoninë e Amerikës, ashtu edhe me sundimin që shpalos një pjesë jo e pakët e mendësisë dhe e koncepteve amerikane.

Në konferencën e dhjetë botërore të popullit rus, e mbajtur në Moskë më 4 Prill të vitit të kaluar, e cila u zhvillua nën drejtimin dhe patronazhin e kishës ruse, pjesëmarrësit, në tërësinë e tyre, ndërmorën fuqimisht një fushatë masive kundër liberalëve perëndimorë, të cilët i vendosën ashpër nën akuzën se "po i zbusin kufijtë mes të mirës dhe të keqes, gjë e cila shkakton prishje të normave të etikës".

Rusia është distancuar plotësisht nga politika e butë dhe e paqëndrueshme që Jelcini kish treguar kundrejt Amerikës. Ajo filloi të ballafaqohet dhe t'i pengojë përpjekjet amerikane për depërtim në shtetet islamike, të cilët ishin dikur pjesë e Bashkimit Sovjetik dhe arriti ta bindë Uzbekistanin që t'i largonte trupat amerikane nga tokat e tija.

Futja në qorrsoakun Irakian s'ka pikë dyshimi që do t'i sjellë Amerikës humbje të mëdha qoftë në autoritet, qoftë në pozitat e saj globale. Turpet dhe gabimet e saj, të cilat po i vërejmë shpesh, sidomos ditët e fundit, si p. sh., vrasja e qytetarëve të pafajshëm (në Hadithe), marrja me qira e burgjeve nëpër Evropën lindore etj. Nga ana tjetër, s'ka pikë dyshimi se këto turpe të saj do të vazhdojnë ngase ajo është agresive dhe zullumqare. Porse, mbas disa kohësh, ajo s'do të jetë më boshti apo shtylla e vetme botërore, siç pretendon me mashtrimet e saj, dhe për të cilën po përgatitej. Planeti ynë patjetër do të jetë në një baraspeshë politike botërore.

Përktheu: Lulzim SUSURI

Të drejtat e njerëzve në Gjermani!?

Shkruan: Vail EXHHURI

Edhe pse feja Islame e ka përfshirë femrën me të gjitha llojet e kujdesit ndaj saj, qoftë ajo nënë, bashkëshorte, motër apo vajzë, perëndimi këmbëngulë në supozimin e tij se femra nuk i gëzon të drejtat e veta në Islam si dhe Sheriati islam, sipas këndvështrimit të tyre, është diktatori më tiran si dhe armiku numër një i femrës. Faktin se mbulesa është obligim për femrën e marrin si pretekst për tu arsyetuar me të kundër Islamit.

Në kohën kur të gjitha mjetet e informimit si ato perëndimore ashtu edhe ato arabe, janë angazhuar me shkrime e programe të ndryshme në vigjilje të asaj që e quajnë "dita ndërkombëtare e gruas" si dhe muajin mars në përgjithësi e quajnë si muaj i gruas, duke përmbajtur në vete shumë festa, të cilat i kanë shpikur si "dita e gruas", "festa e nënës" etj. Përkundër gjithë kësaj, kush i përcjellë këto rrjedha mund ta vërejë, madje me shumë lehtësi, se të drejtat e femrës myslimane e sidomos në



Aktuale



perëndim nuk kanë arritur të respektohen as në minimum si dhe çështja e saj është marginalizuar shumë dukshëm nga dialogët dhe bisedat që kanë rrjedh në këtë relacion.

Revista gjermane "Der Spiegel", e cila ka një shtrirje mjaft të gjerë, para disa ditësh botoi artikullin rreth vështirësive dhe problemeve, me të cilat ballafaqohet femra myslimane në kërkim të punësimit. E çuditshme në këtë rast është, se artikulli qet në pah në mënyrë të qartë, se me këto probleme nuk ballafaqohet vetëm femra myslimane e huaj, por edhe femra gjermane që i ka besuar Allahut për Zot, Islamit për fe dhe Muhamedit, lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, për të dërguar.

Përmbajtja e artikullit

Është femër e arsimuar, fetare dhe e re, mirëpo mbanë mbulesën në kokë dhe për këtë arsye profesoret myslimane, të cilat kanë arritur diploma të studimeve të larta

Pa marrë parasysh se a pajtohem me çështjen e punësimit të femrës apo jo, ky artikull i ngjason thënies Kur'anore në ngjarjen e Jusufit, alejhi selam, me gruan e mbretit, kur një dëshmitar nga familja e saj gjykoi kundër vetë asaj.

Këto janë fakte të shumta, me të cilat ballafaqohen femrat myslimane në vendet ku trumbetojnë natë e ditë lidhur me të drejtat dhe liritë e femrës dhe të minoriteteve

akademike, nuk gjejnë shanse të përshtatshme për punësim. Rezultatet e dala nga këto raste dihen, pra që zonjat myslimane të mbesin në familje si zonja shtëpie në vend se të zënë pozitat e tyre të merituar, që u përkasin niveleve të tyre arsimor. Në këtë formë, një forcë ndikuese, vepruese dhe e vlefshme zhduket nga tregu gjerman i prodhimit. Ka lindur dhe është rritur në një lagje të ngritur të Munihut në Gjermani dhe është bërë

stomatologe. Ka udhëtuar në Malajzi për trajnim dhe për gjysmë viti e përfundon trajnimin dhe kthehet si asistente e mjekut. Më pas dëshiron që të pavarësohet dhe ta ushtrojë profesionin e saj vet. Si një vajzë e re gjermane, e veshur me mantelin e bardhë u pa të jetë aktive.

Kjo vajzë e re gjermane është Nisrinë Faris, dhe është 28 vjeçe. Në kokën e saj mban shaminë. Kjo gjë që shkak, që ajo të bëjë disa ndryshime në jetën e saj arsimore dhe në formimin e personalitetit të saj. Studimi i saj për stomatologji, nuk ishte gjë tjetër përveç një zgjidhje e domosdoshme që kishte zgjedhur për ta lehtësuar mundës-

inë e punësimit pas diplomimit. Ajo e kuptonte me çiltëri se femra myslimane, e cila mban shaminë mbi kokë, nuk do të gjente vend pune të përshtatshëm për te, siç është puna në arsim.

Nisrina është ballafaquar me një sërë vështirësish e problemesh për të gjetur punë në profesionin e saj. Pas një lodhje dhe munde të rëndë, ajo aktualisht punon thuasj pa rrogë fare. Pas më shumë se 130 përpjekjeve për punësim, ajo punësohet si asistente tek një mjek arab, i cili nuk ndien mangësi kur i pohon asaj realitetin gjerman duke i thënë: "Nëse nuk të përshtatet puna me mua, shko ku të duash se askush nuk do të të pranojë në punë, përderisa je e mbuluar!"

Kjo është ajo me çka vuan Nisrinë Faris. Ajo nuk është e vetme në këtë arenë. Asaj i bashkëngjiten shumë prej bijave të familjeve të huaja myslimane, të cilat i përmbahen veshjes islame duke mbuluar kokat e tyre. Ato refuzojnë të zbulohen për hir të ndonjë vendi të punës të përshtatshëm duke e konsideruar si obligim, që ua kanë prej fesë islame.

Unioni i Rinisë Islame në Gjermani si dhe Këshilli për të Drejtat e Femrës Myslimane thonë se problemet, me të cilat është ballafaquar Nisrina dhe shoqe të tjera të saj, janë bërë prej problemeve ditore, me të cilat ballafaqohen femrat e mbuluara në Gjermani, por edhe në mbarë botën perëndimore. Duke e marrë parasysh se diskriminimi fetar konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut, organizatat e ndryshme për të drejtat e njeriut duhet të gjejnë zgjidhje urgjente për këtë.

Këto vështirësi, që kanë të bëjnë me kërkimin e vendeve adekuate të punës, i kanë bërë shumë femra myslimane që të orientohen kah profile të ndryshme, që i bëjnë më pak të atakohen si femra të mbuluara me rastin e punësimit. Kështu që shumë prej tyre i janë shmangur shkollimit në drejtimet, që mund të aftësoheshin për punë si p.sh. mjeke edukatore etj., për

shkak të vështirësive që i gjejnë pastaj, dhe janë orientuar në specializime të ndryshme shoqërore, ose të punojnë në arkat e tregtisë, të cilat i posedojnë prindërit e tyre si projekte private.

Në rrethanat që jeton tregu i biznesit gjerman, konsulentët ekonomistë i këshillojnë bashkëpunëtorët e tyre që ta reflektojnë llojllojshmërinë shoqërore përmes politikës së tyre private në bizneset e tyre.

"Shumëllojshmëria", "gjithëpërfshirja", janë shprehje shumë tërheqëse, por shumica këto shprehje i ngushtojnë në botëkuptimin e kërkesave që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e femrave në shoqëri apo nganjëherë me kërkesat e njerëzve me aftësi të kufizuara. Pjesa më vitale e kuptimit të fjalës, që e injorojnë, është gjithëpërfshirja racore, etnike dhe fetare.

Mishel Shtuper, i cili ka një këshillimorë në Këln të Gjermanisë thotë: "Përzierja është më e mirë. Nuk ka ndonjë shtet në botë, që pozicionohet më ashpër kundër ideve të llojllojshmërisë e gjithëpërfshirjes së Gjermania." Në fjalën e tij, Shtuper vazhdon dhe thotë se çdo gjë, që nuk përputhet me idenë e gjithëpërfshirjes multikulturore, çon në çrregullim e konfuzion. Parimi i tij, të cilin e përfillë vet dhe i këshillon të tjerët me te është "shumëllojshmëria do të thotë sukses më shumë dhe më të madh."

Nga rastet e tjera, që do ta përmendim është edhe ai i Merfi Ertigjonit, e cila ka vuajtur po ashtu prej problemeve të punësimit. Merfi është 26 vjeçare. Ka mbaruar studimet në shkencat ekonomike në kryeqytetin gjerman Berlin. Ajo tregon për veten e saj dhe thotë se të tjerë, që kanë përfunduar të njëjtat studime, kanë paraqitur kërkesa për ta mbajtur praktikën në vende të ndryshme tri a dhjetë herë. Dikush madje ka aplikuar 15 herë. Ndërsa unë, thotë ajo, kam dërguar CV-të në vende dhe kompani të ndryshme 50 herë. Kanë ndryshuar udhëheqjet, por shkaku i refuzimit tim ka qenë një gjithëherë, shamia.

Ertigjon i ka ndjekur të gjitha politikat, strategjitë dhe mënyrat e mundshme për punësim, që përshtatet me mbulesën dhe kualifikimin e saj shkencor. Çështja e saj është sikur çështja e Nisrinë Farisit, që e përmendem më lartë. Nganjëherë kërkesës së saj për punësim ia bashkëngjit edhe fotot personale, nganjëherë jo. Hera të tjera bën thirrje telefonike vet ajo dhe cakton terminin për intervistë. Disa herë ka dërguar njerëz nga jomuslimanët për të ndërmjetësuar, por në fund, rezultati është gjithëherë me dështim sa i përket punësimit. Fjalitë me të cilat përgjigjen janë: ...mbulesa? Jo, të faleminderit!

Kur ndodh që përmes lidhjes telefonike të merret termin për intervistë dhe ndodh takimi, që në momentin e parë rrjedhin përgjigjet: Oh! A ti je ajo? Më falni. Me keqardhje, por nuk mundemi. Nganjëherë para se të hyhet në intervistë u thuhet: lëni gjësendet në orman, e që nënkupton edhe shaminë. Mirëpo Merfi Ertigjon, Nesrinë Faris dhe shoqe të tyre të tjera, këtë gjë nuk e vënë në diskutim asnjëherë.

Në këtë mënyrë armiqtë e mbulesës promovojnë idenë se ajo është simbol politik dhe argument i pakontestueshëm në padrejtësinë dhe persekutimin e femrës. Ata konsiderojnë se është e çuditshme, që femra e arsimuar dhe e pavarur të vuajë nga kjo padrejtësi. Kështu ata e arsyetojnë vetveten për refuzimin e femrave të mbuluar në punësim duke thënë se ajo është e shtypur dhe si e tillë, si mund të punojë ajo në kompanitë e tyre?!

Femrat turke nuk i nënshtrohen intervistave

Monika Hoseman, një ekonomiste gjermane, ka bërë një studim rreth tregut të punës për arabë dhe myslimanë në Gjermani dhe ka ardhur në përfundim se emrat arabë myslimanë, që janë të njohur dhe japin për të kuptuar se bartësit e tyre janë myslimanë, shkaktojnë pengesë në rast konkurrimit për punësim apo mbajtje të

praktikës. Në hulumtimin e saj Monika veç tjerash përmend, se mashkulli apo femra gjermanë kur konkurrojnë në ndonjë vend pune, përgjegjësi për punësim i anulon konkurrentët me emra turq nga lista e konkurrimit. Kurse femrat turke, të cilat i posedojnë të njëjtat kualifikime me ato të femrave me nacionalitete të tjera evropiane, presin pa dobi për të hy në intervistë, për shkak shumë të thjeshtë, sepse përmes fletëve të aplikacionit është bërë përzgjedhja paraprakisht dhe turket veç janë eliminuar.

Mishel Shtuper, konsulenti publik, ka një propozim që ndoshta nuk iu pëlqen shumë muslimanëve. Ai mendon se të dy palët; pala punëdhënëse gjermane si dhe pala punëkërkuese, femrat myslimane të mbuluar, duhet të lëvizin njëra në drejtim të tjetrës. Femra myslimane, mendon ai, duhet të tregojë gatishmëri për heqjen e shamisë, dhe kjo duhet të jetë vetëm gatishmëri jo edhe realitet, derisa ta bind opinionin se ajo ec e mbuluar me shami nga bindja e saj për te dhe se nuk është ushtruar kurrfarë lloji i dhunës mbi te.

Në fund, pa marrë parasysh se a pajtohemi me çështjen e punësimit të femrës apo jo, ky artikull i ngjason thënies Kur'anore në ngjarjen e Jusufit, alejhi selam, me gruan e mbretit, kur një dëshmitar nga familja e saj gjykoj kundër vetë asaj.

Këto janë fakte të shumta, me të cilat ballafaqohen femrat myslimane në vendet ku trumbetojnë natë e ditë lidhur me të drejtat dhe liritë e femrës dhe të minoriteteve. Në kohën kur një i huaj perëndimor që punon në ndonjë vend islam respektohet si ekspert dhe gëzon privilegje më të larta se ato që i gëzojnë vet nënshtetasit myslimanë.

Përktheu:

Muhamed DËRMAKU

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

Arabët hajdutë?!

Si ndikojnë mediumet e sidomos filmi dhe si pasqyrohet religjioni nëpër media
Mediat dhe ndikimi i tyre

Shkruan: Agron KURTISHI

Sigurisht që e dimë mirë se si mediat kanë një ndikim të jashtëzakonshëm te njerëzit dhe kjo nuk duhet te nënvlerësohet, por duhet të studiohet me një vëmendje të veçantë, për shkak se mediat janë një ndikues masiv. Jemi dëshmitarë se si mediat ndikojnë në ndryshimin e shoqërisë dhe të jetës së përditshme të njerëzve. Ata ndikojnë në atë se si ne sillemi me prindërit, të afërmit, shoqërinë, se si ushqehemi dhe kur ushqehemi, kur kemi kohën për gjumë, kur kemi kohën e pushimit etj.

Në bazë të ofertës së madhe medi-atike (është i pafund numri i kanaleve televizive) njerëzit bëhen të varur nga konsumi i mediave e sidomos nga televizori. Këto shfaqje dalin në dukje ngaqë gjigandët e mediave i manipulojnë shikuesit dhe i dirigjojnë si "kukulla te tyre".

Shumë njerëz dëshirojnë ta mbushin kohën e tyre të lirë me televizorin.

Mediat sot janë një pjesë përbërëse e integruar e realitetit shoqëror. Ato bëjnë pjesë në përditshmërinë e familjes dhe të

shkollës. Përveç familjes, edhe mediat janë bërë edukuese. Mediat trajtojnë tema të ndryshme të jetës shoqërore dhe ndikojnë shumë në rregullimin dhe ndërtimin e jetës së moshave fëmijërore dhe rinore, gjë që ndikon shumë herët edhe në arsimim dhe në edukim familjar dhe shkollor. Nuk duhet te nënvlerësohet edhe fjala e Naom Chomsky-t i cili thotë që: "sot, një ushtri e madhe dhe profesioniste (njerëzit që punojnë dhe udhëheqin mediat) punojnë pa pushim për t'i ndryshuar bindjet tona për çështjet esenciale te jetës".

Televizioni bashkon fotografinë e lëvizshme, zërin dhe tekstin dhe kjo është arsyeja që ky lloj mediumi na bind aq fort.

Mediat, ku një pjesë shumë të rëndësishme e zë padyshim Hollivudi, nuk i reflektojnë dhe as nuk i respektojnë vlerat familjare të shumicës së popujve. Me këtë ide është edhe Keith Merrill kur thotë se "Hollivudi është shndërruar në sinonim për ideologji ekstreme

"Sot, një ushtri e madhe dhe profesioniste (njerëzit që punojnë dhe udhëheqin mediat) punojnë pa pushim për t'i ndryshuar bindjet tona për çështjet esenciale te jetës".

Artikuj



ndikon në të ashtuquajturën "pavetëdijen" tonë.

Udhëheqësit e mediave e shfrytëzojnë fuqinë e hatashme komunikuese të fotografisë për të dhënë deklarata mbi religionin, politikën, kulturën, etnitetin, racën, popullatat etj. Ata komunikojnë idetë, ndërsa idetë motivojnë sjelljen e njeriut. Kështu mediat përdorin fuqinë e vet duke portretizuar popullata të tëra të shoqërisë tonë në mënyrë negative ose stereotipie, që shumë lehtë mund të ndikojnë në paragjykime të ndryshme ndaj një popullate. Të gjitha mediat kontrollohen nga një grup i ngushtë njerëzish, të cilët mbajnë peng industrinë mediatike dhe përderisa nuk ndryshon kjo gjë, nuk ka pra as demokraci. Jo më kot thuhet që: mediat janë pushteti i katërt dhe jo më kot thuhet që: ai që sundon mediat, sundon botën.

liberale të përcaktuar nga një filozofi të humanizmit shekullar, nga shturja seksuale, nga martesat homoseksuale, anti-religjion, pro abortim, pro-dhunë, produhan, pro-sharje, pro-alkool, anti-familje, anti-traditë, anti-prind, anti-autoritete. Kjo është një ideologji, e cila ka gjithnjë dhe më pak pika të përbashkëta me vlerat tradicionale të botës së civilizuar. Me këtë tregohet që armiku (apo mediumet) nuk dëshiron ta vrasë audiencën, por dëshiron që ta mbajë peng për të mos e lëshuar asnjëherë. Duke përdorur "armët e tyre", mediat na kapin dhe na fusin në një errësirë ku na mbajnë 2-3-4 ose më shumë orë, për të na konvertuar, jo vetëm me atë që paraqet dhe thotë por edhe me atë që nuk e paraqet dhe nuk e thotë e për habi

Feja nëpër media

Të bëjmë një lidhje të kësaj që e thamë më lartë me religjionin. Duket shumë qartë që besimi në një Zot të vetmin dhe Absolut është braktisur ose injoruar sepse shumë njerëz, nën ndikimin e mediave (televizionit, filmit, kinemasë, radios) kanë filluar të besojnë në njeriun e jo në Zotin Fuqiplotë. Robert Knight thotë se: "Nocioni se e vërteta dhe moraliteti janë kategori relative ka arritur statusin e dogmës për shumicën e njerëzve" Për Knight-in: Relativizmi paraqet kultivim të injorancës, shikim të rrejshëm të realitetit, të konstruktuar nga injorantët për injorantët, mjet jashtëzakonisht efikas për propagandë,

ndërsa kultura dhe edukata që merret nga mediat paraqesin mjetin më efikas për përhapjen e relativizmit".

Industria mediatike mundohet të reflektojë diturinë që ka bota perëndimore për Islamin. Këtu e shikojmë që kjo industri ka shumë pak informata dhe njohje mbi këtë çështje. Ata e shabllonizojnë racën arabe si bartëse kryesore të karakteristikave kulturore të një besimtari mysliman. Me plot bindjen mund të themi që arabët kanë qenë një prej grupeve që janë paraqitur më keq nga mediat e ndryshme, e sidomos nga filmi dhe po këto janë ngarkuar me stereotipe të ndryshme negative. Ata nëpër filma të ndryshëm janë paraqitur si kriminel, mashtrues, hajdutë, të çmendur, barbarë dhe vrasës, njerëz të klasës së ulët, të pakrahasueshëm me kulturën evropiane dhe amerikane. D.m.th., arabët paraqiten në çdo formë, por vetëm si arabë të vërtetë nuk paraqiten. Ata janë paraqitur nëpër filma të ndryshëm edhe si terroristë që kanë pasur për qëllim të vrasin një numër të madh personash dhe bashkë me ta edhe presidentin amerikan, ata janë bërë pengmarrës të grave perëndimore, sulmojnë fëmijë perëndimore, paraqiten si specialistë për tortura etj. Është interesant që filmi as që përdor arabë të vërtetë në rolet e tyre, me bindjen që këta as nuk janë të aftë të luajnë një rol të tillë, çka do të thotë se përsëri kemi të bëjmë me një stereotipizim. Për këto role përdoren aktorë si p. sh: Rudolf Valentino, Shon Koneri, Richard Gir etj.

Edhe në kohën e sotme arabët vazhdojnë të paraqiten në forma nga më negativet. Rast interesant është edhe filmi i

"Hollivudi është shndërruar në sinonim për ideologji ekstreme liberale të përcaktuar nga një filozofi të humanizmit shekullar, nga shthurja seksuale, nga martesat homoseksuale, anti-religjion, pro abortim, pro-dhunë, pro-duhan, pro-sharje, pro-alkool, anti-familje, anti-traditë, anti-prind, anti-autoritë.

animuar për fëmijë Aladini i kompanisë së njohur Walt Disney. Këtu do të thellohem pak më shumë, ngaqë në qoftë se filmat e tjerë për të rritur nuk do të ndikojnë në persona që e njohin realitetin, filmat e animuar janë më të besuar dhe prindërit i lënë fëmijët në plotëbesim për t'i shikuar këta filma. Aladini bazohet mbi tregimin nga legjendat arabe për Aladinin, Ali Babën dhe 40

hajdutët. Edhe në këtë film vazhdoi paraqitja negative dhe stereotipe e myslimanëve dhe kulturës së tyre me anë të fotografive dhe fjalëve. Aladini paraqitet si një rrugaç i varfër arab. Këtu paraqiten edhe figura të tjera si Veziri, Sulltani, Xhafari dhe banditi Kazim. Banditi është i parregulluar, i palarë, i veshur me rroba të vjetra e të grisura. Edhe Xhafari përmban këto karakteristika, duke shtuar dukjen e keqe dhe aksentin. Edhe pse ky film është shfaqur për fëmijë, ai përmban shumë skena në të cilat arabët tregohen si tejet të dhunshëm. Çfarë kuptojmë nga kjo? Shumë thjesht: fëmijët duhet të edukohen dhe të rriten me një frymë anti-arabe dhe anti-islame. Diku më sipër vura në dukje faktin se mediat ndikojnë më shumë në pavetëdijen tonë dhe pikërisht kjo pavetëdije ndikon në formë dhe në mënyrë afatgjatë në sjelljen tonë. Aspekti afatgjatë qëndron në faktin se gjatë gjithë kohës fëmija do t'i ketë të ngulitura mirë në psikë pamjet dhe imazhet e filmit. Në këngën "Netët e Arabisë", që këndohet në filmin e animuar që po trajtojmë, një frazë thotë: "Arabia është vend barbar". Çka do të thotë se Hollivudit as që i shkon ndërmend që të ndryshojë gjësend në tërë "pikturitjet" e veta mbi Myslimanët dhe Arabët. Myslimanët, që nga koha kur



nisi industria e filmit, paraqiten në forma nga më negativet. Sikundërse kemi pat rastin ta dëgjojmë dendur, fjala dhe bindja e tyre mbetet gjithnjë e njëjtë: kundërshtari gjeografik është arab, ndër- sa ai ideologjik është islami.

Ku është harruar etika? A është etike dhe e lejuar të fyesh një kulturë dhe një fe? Etnocentrizmi mbisundon nëpër të gjithë mediat dhe në veçanti në mediu- min e filmit.

Një prift me emrin Dave Christiano, përdor formën e tregimit didaktik, në të cilin figura e djallit ndër të tjera thotë: "Ne ndikojmë nëpërmjet Hollivudit dhe industrisë së argëtimit (mediemeve). E kemi mashtruar 99 % të popullatës. Një familje amerikane ngulet mesatarisht 7 orë në ditë përpara ekranit të televizorit, ndërkohë që një familje e mesme nuk lexon në ditë asnjë fjalë nga Bibla. Dhe pastaj thonë se Krishti është Perëndi. Porse perëndia e tyre është vetëm argë- timi, atij ia përkushtojnë të gjithë kohën. Nëpërmjet filmave, videove dhe tele- vizionit kemi pesëqindfishuar çdo të

Me plot bindjen mund të themi që arabët kanë qenë një prej grupeve që janë paraqitur më keq nga mediat e ndryshme, e sidomos nga filmi

keqe të mundshme në Amerikë. Madje, edhe më shumë. Krimet, abortimet, mashtrimet, prostitucioni janë shumë- fishuar që nga çasti kur morëm kahun e argëtimit. Dhe mbani mend demonë... Hollivudi sundon!

Morali: Nuk ka shtëpi pa televizor, madje, në ditët tona fëmijët kanë një të tillë edhe në dhomën e tyre. Shumë prindër krenohen me fëmijën/t e tyre që sheh/shohin televizor në dhomën e tij/tyre pa bërë "zhurmë". Të mos habitemi kur dikush "ndryshon". Duhet ta përqendrojmë vëmendjen sidomos te gjeneratat e reja, të cilat mund të ndiko- hen fare lehtë nga mediat e ndryshme.

Le të jetë ky shkrim fillimi i një udhëz- imi të shëndoshë e të vetëdijshëm medi- atik.

(autori është profesor pranë UEJL)

Kriteret e të mençurve

19

Shkruan: Dr. Xhafer Shejh IDRIS

Hyje

Krahas cilësive trupore njerëzore, që së bashku me veçoritë dalluese shoqërore i klasifikojnë njerëzit, sipas kohës, vendit dhe rrethit ku ata jetojnë, ekzistojnë edhe veçori shpirtërore. Njerëzit nuk janë, ashtu siç pretendojnë t'i paraqesin disa teori perëndimore, të burgosurit e qelizave kulturore, ndikuese në mënyrën e të menduarit dhe në mënyrën e të zgjedhurit. Assesi. Kulturat e njerëzve të ndryshëm përfshijnë besimet e tyre, vlerat dhe botëkuptimet dhe shpeshherë profilizohen brenda qytetit modern. Çdo qytet ka veçoritë dhe natyrën e vet, i cili si i tillë ndikohet nga qytetet tjera, me të cilët është i ndërlidhur me rrugë të shtruara dhe mjete të ndryshme të komunikimit. Po të ishte ashtu si pohojnë këto teori, njerëzit nuk do të kishin mundësi të kuptohen mes vete, e as të ndryshojnë besimet dhe botëkuptimet të trashëguara në kulturat e tyre.

Kjo nuk do të mundej të ndodhë pa ekzistimin e atyre veçorive të përbashkëta shpirtërore, prej të cilave atë më të rëndësishmen, do ta quajmë "Standardet e mençurisë" të cilët i pranon çdo njeri edhe pse jo çdoherë i zbaton apo i pranon rezultatet e tyre.

Disa individ duke i vështruar dallimet mes njerëzve, i godet dëshpërim dhe humbje shprese: Ky është besimtar e ky ateist, ky është mysliman e ai krishterë, çifut ose budist, ky është anëtarë i filan xhematit ose partisë e ky tjetri i tjetrës.

Disa individ duke i vështruar dallimet mes njerëzve, i godet dëshpërim dhe humbje shprese: Ky është besimtar e ky ateist, ky është mysliman e ai krishterë, çifut ose budist, ky është anëtarë i filan xhematit ose partisë e ky tjetri i tjetrës.

me të cilët, pranon ose refuzon qëndrime, nuk do të lejonte të kaplohet nga pashpresa.

Në vijim do të përmendi disa kriteret e mençurisë, njohjen e të cilëve Allahu na e ka obliguar në Kur'an dhe na ka detyruar të gjykojmë me të. Këto kriteret janë prej argumenteve

më të forta se kjo fe, Islami, është fe e natyrshmërisë, fe e cila i drejtohet njeriut, qenies të përkufizuar me kulturë, kohë dhe vend të caktuar.

Prej kriterëve të pranuar nga gjithë kategoritë e mençura të llojit njerëzor janë:

1. Ligjet e logjikës

Kam për qëllim premisat logjike dhe përfundimet e tyre të pashmangshme, parimet me të cilët njohim saktësinë apo jo saktësinë e fjalisë. Prej këtyre ligjeve është "Ligji i simetrisë" ose i

Artikuj

quajtur ndryshe i "mënjanimi të kontradiktave" ligji ky i cili është bazë dhe thelb i ligjeve të logjikës.

Gjithë njerëzit, madje edhe fëmijët, kuptojnë kotësinë e fjalisë kontradiktore.

Fjalinë tënde: "Ta kam sjellë sot një dhuratë të bukur por nuk ta kam sjellë sot atë dhuratë të bukur" edhe fëmija do ta vlerësonte si e pakuptimshme.

Çdonjëri është në gjendje të vërteton pakuptimin e fjalive: Do të blej veturë dje, ose kam blerë veturë nesër. Megjithatë, jo çdo fjali kontradiktore është e thjeshtë dhe e qartë në kontradiktën që përmban, dhe si e tillë kërkon më tepër se një shikim dhe analizë sipërfaqësore.

Shembulli i tillë është fjala e Mu'tezilëve: Njeriu është krijuesi i veprave të tij. Nga kjo fjalë nënkuptojmë se në botë ekzistojnë disa sende të cilat nuk i ka krijuar Allahu, subhanehu ve tealë, pohim ky i cili ndeshet me ajetin: "Allahu është krijues i çdo sendi..." (Ez Zumer, 62). Përgënjeshtrimi i Kur'anit është kufër, ky parim a na jep të drejtë të shpallim si mosbesimtarë çdonjërin i cili e thotë këtë fjalë? Assesi; shembulli i mëshirës me të cilën dallohen pasuesit e sunnetit është rregulli sipas të cilit: ajo që detyrimisht nënkuptohet prej fjalës jo çdoherë e ka të njëjtën dispozitë (nuk gjykojmë që njeriu i cili e ka thënë atë fjalë detyrimisht e ka pasur për qëllim atë kuptim i cili me parimet e logjikës dhe mençurisë medoemos nënkuptohet prej fjalës).

Prej mjeteve më të mira për argumentimin e kotësisë të ndonjë fjalie, është nxjerrja në shesh të pohimeve të gabuara që doemos nënkuptohen prej saj.

Për shembull: Kur çifutët deshën të mohojnë pejgamberinë e Muhamedit,



paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, u mbështetën në rregullin e përgjithshëm: "Allahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu!" (El En'am, 91) nga i cili patjetërsueshëm arrijmë në përfundim se Allahu nuk i ka shpallur Musait, alejhi selam, Tevratin, për të cilin vetë çifutët besojnë se është fjalë e Zotit; për këtë shkak Allahu, subhanehu ve te'ala, atyre u drejtohet me pyetje denoncuese: "Thuaj: "Kush e zbriti librin, me të cilin erdhi Musai e që ishte dritë e udhërrëfyes për njerëz..." (El En'am, 91)

Ndoshta vendi ku në mënyrë më eksplicite, u përmend ky kriter në Kur'an, është ajeti: "A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie." (En Nisa, 82)

Ky ajet duke e mohuar praninë e kundërthënies në Kur'an, mosekzistimin e tyre e promovon si argument që vërteton se Kur'ani është i shpallur prej Allahut. Nuk është e mundshme që një krijesë të shkruan libër si Kur'ani, të veçantë për nga madhësia, llojllojshmëria e temave, për nga rreziku i tyre dhe koha e gjatë e shkrimit, e që në të, të mos ketë

kundërthënie. Nëse do të vërtetosh saktësinë e këtij pohimi shih librat e shkruara prej njerëzve në të cilët ata vetë pranojnë mospajtimin e asaj që e kanë shkruar para disa vjet me atë të cilën e pohojnë sot. Analizo me vëmendje teoritë njerëzore si demokracia, kapitalizmi, socializmi etj. dhe do të gjesh kontradikta numrin e të cilëve e di vetëm Allahu. Prania e kundërthënies ishte shkak që disa të krishterë (që quhen krishterë liberalë) të mohojnë përshkrimin e çdo gjëje që përmendet në Bibël si fjalë e Zotit. Kjo gjendje (prania e tepërt e kundërthënies në Bibël) ishte shkak që shumica e tyre të mohojnë krishterimin si fe.

Ekzistimi i këtij kriteri në natyrshmërinë e njeriut ishte shkak që shtyri Shejhul Islam Ibën Tejmijje, për logjikën greke, të thotë: Është dije për të cilën nuk ka nevojë i mençuri e as që mund të përfiton prej saj ai që nuk ka arsye .

Ndoshta pohimi i Shejhul Islam do të ishte më preciz po të formulohej vetëm kështu: (Logjika) është dije që nuk i nevojitet të mençurit, sepse gradat e jo arsyesh dallojnë dhe çdo njeri, sa do i marrë që të jetë, ka njohuri për këtë kriter (ligji i simetrisë) aq sa i nevojitet në përdorimin ditor.

Kjo më bënte që shpeshherë të habitem me disa perëndimorë që thoshin: Logjika është gjë e veçantë për kulturën perëndimore dhe është e panjohur për popujt e tjerë. Njëri prej orientalistëve u kap fortë për këtë fjalë të kotë dhe u orvat ta vërtetojë si të saktë edhe për arabët, dhe duke folur në emër të arabëve tha:

"Ajo që del si përfundim prej kësaj

është që nëse ne në Kur'an gjejmë ndonjë kundërthënie, ajo do të jetë provë për pasurinë e tij, dhe tejkalim i frytshëm i mendimit të thatë analitik. Do të kemi mundësi të ruajmë të dy kuptimet sepse çdonjëri prej tyre nxjerr në shesh realitetin e neglizhuar nga tjetri, dhe si të tillë, edhe pse ngelim të paaftë t'i bashkojmë, na japin fotografi më të qartë për të vërtetën."

Arabët si gjithë popujt tjerë e kanë të patjetërsueshme të perceptojnë kotësinë e fjalive kundërthënese, dhe për këtë ata në gjuhën e tyre kanë dëshmi aq shumë saqë shënimi i tyre është një detyrë e vështirë. Këto kritere nuk mundën të jenë të veçantë për evropianët ashtu siç nuk mundën

shembulli i mëshirës me të cilën dallohen pasuesit e sunnetit është rregull sipas të cilit: ajo që detyrimisht nënkuptohet prej fjalës jo çdoherë e ka të njëjtën dispozitë

të jenë të veçantë për arabët. Këtë e vërteton ekzistimi i gjuhëve të ndryshme për komunikim mes individëve të shoqërisë që e flet atë gjuhë, dhe si të tilla (gjuhët) duhen të përmbajnë fjalë për

mohimin dhe pohimin, që nuk mundën të përdoren drejtë pa rregulla për të vërtetuar atë që duhet pohuar ose mohuar. Këto rregulla janë ligji i simetrisë.

Pohimi i më tepër se një të vërtete për një gjë nënkupton mohimin dhe pohimin e saj në një kohë, lejueshmërinë dhe ndalimin e saj, mundësinë dhe pamundësinë e saj.

Sa bukur ka thënë Imam Shatibiu: "Në Sheriat çdo gjë kthehet te një fjalë e cila është e vetmja e vërtetë edhe atëherë kur ka shumë mendime për një çështje. I njëjti parim vlen edhe për bazat (themelet). Argumentet për këtë janë..."

Megjithatë disa njerëz duke synuar argumentimin e pluralizmin e të vërte-

Shejhul Islam Ibën Tejmijje, për logjikën greke, të thotë: Është dije për të cilën nuk ka nevojë i mençuri e as që mund të përfiton prej saj ai që nuk ka arsye .

tave akoma përmendin rastin e dy grupeve të as'habëve që ndryshe kuptuan fjalët e të Dërguarit, salallahu alejhi ve selem: Ai që beson në Allahun dhe Ditën e fundit, të mos e falë namazin e iqindisë përpos te Beni Kurejdha... Pranimin e dy mënyrave të kuptimit të hadithit, që mes vete janë kontradiktore (sipas tyre), ata e konsideruan argument për mundësinë e ekzistimit e më tepër se një të vërtete.

Kjo assesi nuk ka mundësi të kuptohet nga vepra e të Dërguarit, salallahu alejhi ve sel-lem, i cili vetëm pranoi veprën e çdo grupi sipas kuptimit të tyre të hadithit. Ata të cilët u falën para se të arrijnë te Beni Kurejdha ishin të mendimit se vonimi i namazit është gabim, në kohë që të tjerët ishin të mendimit se përsheptimi i namazit është gabim. I Dërguari i Allahut u shpjegoi atyre, se mënyra se si ata e kanë kuptuar hadithin është e lejuar dhe nuk ka kundërthënie mes tyre. Lejohet që namazi të falet në fillim të kohës ashtu si lejohet të falet në fund të kohës, dhe i njëjti parim vlen për lejueshmërinë e faljes para se të arrihet te Beni Kurejdha dhe pas arritjes te Beni Kurejdha.

Biseda jonë ka vazhdim...

Përktheu: Talha KURTISHI

Dhe njerëzve foluni fjalë të mira 3/3

Shkruan: Ekrem AVDIU

Udhërrëfyes i besimtarit në realizimin e këtij objekti fisnik islam gjithsesi duhet të jenë udhëzimet të cilat deri te ne përcillen nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekim i Allahut qoftë mbi të. Ai që u përmbahet këtyre udhëzimeve të ndritshme, nuk ka mundësi të mos jetë shembull dhe më i miri në sjellje. Atij do t'ia kenë lakmi të gjithë. Abdullah b. Amri tregon se Muadhi i ka thënë të Dërguarit të Allahut: Më këshillo diçka. Ai i ka thënë: "Qëndro paluhatshëm në besim dhe sjellja jote me njerëzit le të jetë sa më e mirë." Ndërsa Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me të, rrëfen se i Dërguari i Allahut i ka thënë: "Kije

dronë e Allahut kudo që të jesh, pas veprës së keqe bën vepra të mira dhe me njerëzit sillu me sjellje të mirë."

S'do mend se jetësimi i këtyre udhëzimeve madhështore më së shumti vjen në shprehje nëpërmjet kontakteve mes njerëzve, e ato më së shpeshti realizohen nëpërmjet të folurit. Kur dikush i drejtohet muslimanit me fjalë të mira, ky është i obliguar që t'ia kthejë me më të mira. Vetëm në këtë mënyrë mund të dëshmojë praktikisht se i përket fesë më të ndritshme dhe është pjesëtar i ummetit, shenjë mbrojtëse e të cilit është korrektësia dhe sjellja e mirë. Një njeri e ka pyetur Seid b. Xhubejrin: Një zjarrputist zakonisht më përshëndet dhe sillet mirë me mua, a t'ia kthej me të mirë? Ai i është përgjigjur: E kam pyetur për këtë Ibën Abbasin, Allahu qoftë i kënaqur me të dhe më ka thënë: Sikur faraoni të ishte e mundur të më thoshte një fjalë të mirë, unë do t'ia ktheja me të mirë.

Në të vërtetë sjellja e keqe nuk i bën keq askujt më shumë se sa vet atij që sillet ashtu. Në këtë më shumë përparësi bëjnë pjesë edhe fjalët ngase të folurit pa vend u ka kushtuar shtrenjtë njerëzve gjithnjë. Ndoshta organi që më së shumti shkakton komplikime në jetën e njeriut është gjuha, andaj edhe aktiviteti i saj është aq i ndjeshëm dhe i rrezikshëm. Krejt kjo vjen si pasojë e obligueshmërisë së të sjellurit mirë me njerëzit dhe të folurit mirë atyre. Mirëpo kjo obligueshmëri, te disa kategori njerëzish sa vjen e rritet.

Dijetarët islamë janë njerëz të cilët



Allahu i ka ngritur në pozitë të lartë dhe masave të gjera ua ka obliguar respektin dhe sjelljen e mirë ndaj tyre. Ata duhet të respektohen për shkak të dijes që bartin dhe mirësisë që muslimanët përjetojnë falë aktivitetit të tyre. Ata janë pishtarët dhe kandidat ndriçues në jetën

e muslimanëve, ngase atyre ua mësojnë atë që është më e mira dhe që i afron tek Allahu i Madhëruar. "Allahu i ngritë ata që besojnë dhe u është dhënë dituria na grada të larta." (Muxhadele, 11) Vlera e dijetarëve kuptohet prej rolit që ata luajnë në përmirësimin e jetës dhe veprimtarisë së muslimanëve. Ata janë trashëgimtarët e vetëm legjitimë të të Dërguarve të Allahut ngase të Dërguarit e Allahut nuk kanë lënë pas vetes pasuri, dinarë e as dërhëmë, por kanë lënë diturinë, dinjitetin dhe sjelljen e mirë, andaj kush merr prej saj, merr mjaft.

Sjellja e sahabëve me të Dërguarin e Allahut është shembulli më i mirë se si duhet të respektohen dijetarët dhe njerëzit me autoritet. El-Bera b. Azibi tregon se për një kohë të gjatë ka dashur t'i bënte pyetje të Dërguarit të Allahut për ndonjë gjë, por turpi që ishte rrjedhojë e respektit të madh e pengonte.

Ai madje thotë se gëzoheshim shumë kur vinte ndonjë beduin, ngase beduinët akoma nuk ishin gdhendur me rregullat e mirësjelljes andaj pyesnin nganjëherë edhe për gjëra shumë banale, për të cilat rëndom sahabët turpëroheshin të pyesnin. E kanë pyetur një herë Abbasin, axhën e të Dërguarit të Allahut: A je ti më

Sikur faraoni të ishte e mundur të më thoshte një fjalë të mirë, unë do t'ia ktheja me të mirë.

i madh apo i Dërguari i Allahut? Ai është përgjigjur: Ai është më i madh, ndërsa unë kam lindur para tij. Ndërsa Enes b. Maliku, sipas asaj që shënon Buhariu në librin "El-edebul-mufred", transmeton se kur dikush trokiste për ndonjë arsye në derën e të Dërguarit të Allahut, trokiste me thonj, nga kujdesi i madh për të mos shkaktuar zhurmë dhe shqetësim për të dhe familjen e tij. Shembujt e respektit të veçantë që sahabët kishin për të Dërguarin janë të shumtë dhe të llojllojshëm.

Ajo që duhet patjetër të mësojmë prej këtyre sjelljeve është se dijetarët dhe njerëzit me autoritet duhet të respektohen dhe për ta duhet, krahas sjelljeve shembullore duhet folur fjalë të mira. Nganjëherë, mëkatet të cilat rëndom kanë një peshë të caktuar, bëhen edhe më të rënda kur ato bëhen ndaj njerëzve të caktuar. Përgojimi, për shembull, është mëkat shumë i rëndë, por nëse dikush i përgojon dijetarët, ai ka bërë mëkat edhe më të rëndë sesa vet përgojimi i një njeriu të thjeshtë. Kjo është kësaj ngase paprekshmëria dhe shenjtëria e dijetarëve është shumë e madhe. Dijetarët e mëdhenj të Islamit kanë dhënë shembull të shkëlqyeshëm me respektin që kanë treguar ndaj mësuesve të tyre dhe dijetarëve tjerë. Është pyetur Ebu Vaili për Rebi' b. Huthejmin, se cili prej dy dijetarëve është më i vjetër. Ai është përgjegjur: Unë jam më i madh se ai më vjet, ndërsa ai është më i madh se unë me dije. Dijetari i njohur el-Iraki thotë: "Nuk i takon muhadithit të flasë në prezencën e

. Përgojimi, për shembull, është mëkat shumë i rëndë, por nëse dikush i përgojon dijetarët, ai ka bërë mëkat edhe më të rëndë sesa vet përgojimi i një njeriu të thjeshtë.

Dijetarët islamë janë njerëz të cilët Allahu i ka ngritur në pozitë të lartë dhe masave të gjera ua ka obliguar respektin dhe sjelljen e mirë ndaj tyre. Ata duhet të respektohen për shkak të dijes që bartin dhe mirësisë që myslimanët përjetojnë falë aktivitetit të tyre.

atij që është më i ditur se ai." Sufjan eth-Thevriu i ka thënë Sufjan b. Ujejnës: "Ç'ke që nuk po flet?" Ai u përgjigj: "Derisa je ti këtu unë nuk flas."

Të gjitha këto raste kanë të bëjnë me njerëz të mëdhenj, të rangut të njëjtë për afërsisht, megjithatë, ata njerëz tregojnë shumë respekt për njëri tjetrin, për shkak të dijes që mbanin dhe autoritetit që kishin.

I Dërguari i Allahut ka thënë: "Nuk është prej neve ai që nuk e nderon të madhin, mëshiron të voglin dhe ia di vlerën dijetarit."

Thënë me një fjalë, dijetarët duhet të nderohen dhe respektohen për shkak të asaj dije që bartin në vete, për shkak të fjalës së Allahut, mësimëve të të

Dërguarit dhe për shkak se ata janë mësuesit që njerëzve ua mësojnë hairin. Ata kanë autoritet tek Allahu, andaj duhet të jenë të nderuar edhe te njerëzit. Borxhi që u kemi atyre është shumë i madh. Ai mund të lahet nëse i nderojmë, respektojmë dhe sillemi mirë me ta. Nëse një personi duhet t'i jemi mirënjohës për shkak të një të mire të kësaj bote që na e ka bërë, atëherë dijetarëve duhet tu jemi edhe më mirënjohës ngase ata na e mësuajnë fenë, që është çelësi i suksesit dhe lumturisë në të dy botët.

Në anën tjetër, ofendimi i tyre është ofendim ndaj Islamit dhe një gjë e tillë zakonisht ndodhë prej atyre që në të vërtetë kanë urrejtje dhe armiqësi ndaj Islamit.

Ofendimi i tyre është ofendim ndaj Islamit dhe një gjë e tillë zakonisht ndodhë prej atyre që në të vërtetë kanë urrejtje dhe armiqësi ndaj Islamit

Testi i sprovës!

Shkruan: Ulvi FEJZULLAHU

Lavdia i takon Allahut, Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Mëshirës, Muhamedin, salallahu alejhi ue selem.

Një njeri është besimtar vetëm atëherë kur beson se Allahu është Sundues i gjithësisë dhe sundues tjetër nuk ekziston, vetëm Ai është Zot dhe vetëm Ai meriton të adhurohet dhe Ai është plotësisht i përsosur me cilësitë dhe emrat e Tij. Në këtë mënyrë, besimtari ka konfirmuar njësimin (teuhidin) e adhurimit, zotërimit, si dhe emrat e Allahut dhe cilësitë e përsosmërisë së Tij. Ky është teuhidi, besimi që duhet të qëndrojë në zemrat e gjithë besimtarëve.

Po ashtu, duhet kujtuar se besimi nuk është vetëm fjalë, e cila thuhet me gjuhë, por është vërtetësi me detyra, obligime dhe përgjegjësi. Nuk mjafton thjesht që njerëzit të thonë: besojmë dhe veprojmë e këta të mos të ballafaqohen me teste, sprova, vuajtje, shqetësime. Besimtarët ndeshen me shqetësime dhe sprova të natyrave të ndryshme. Është e natyrshme të bëhen teste dhe analiza në sfera dhe lëmi të ndryshme. Blerësi kërkon të testohet sendi që blihet, studenti po ashtu i nënshtrohet provimit pranues kur aplikon për studime; punëtori i nënshtrohet intervistave, e kështu me radhë.

Një prej ligjeve të Allahut të Lartësuar është që besimtari të testohet me një provim të përgjithshëm, ku i jepet mundësia për të marrë notë të lartë apo mesatare, por mund të marrë edhe notë të



Artikuj

dobëta dhe jo kaluese. Pyetjet e përgatitura janë të hapura dhe të njohura për të gjitha shtresat e njerëzve. E njohur, po ashtu, është edhe lënda e provimit, notat kaluese dhe rëndësia e këtij provimi.

Lënda e provimit është imani-besimi. Në Kur'an, Allahu i Lartësuar ka thënë: "A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar, dhe nuk do të sprovohen?" (Ankebut, 2)

Pyetjet e provimit testues janë të përmbledhura në fjalën e Allahut të Lartësuar: "Ne do t'ju provojmë me ndonjë frikë, me uri, humbje të pasurisë, të jetës, të frutave. Por t'i përgëzoi durimtarët." (Bekare, 155)

Vendmbajtja e provimit testues është kjo botë, dynjaja; përderisa njeriu jeton, ai do të testohet. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të lakmuarit, si ndaj grave, djemve, ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, kuajve të stolitur, bagëtisë dhe bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë." (Ali-imran, 14)

"Shembulli (ngjashmëria) i jetës së kësaj bote është si i një shiu që Ne e kemi sjellë nga qielli, e me anën e të cilit gërshetohen (mbijnë dhe shpeshetohen të gjitha llojet) bimët e tokës prej nga hanë njerëzit e kafshët deri kur toka të ketë marrë stolinë e vet dhe të jetë zbukuruar (me bimë, pemë e behar), e banorët e saj të mendojnë se janë të zotët e saj, e asaj i vjen urdhri Ynë, natën ose ditën, Ne e bëjmë atë (të mbjellat) të korrur sikurse të mos ekzistonte dje. Kështu Ne ua sqarojmë faktet njerëzve që mendojnë." (Junus, 24)

Më pas, besimtarit i duhet që të marrë masat e nevojshme për t'i krijuar vetes mundësitë për ta kaluar me sukses testin provues dhe kjo arrihet me durim dhe namaz. Allahu i Lartësuar ka thënë:

"Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin)." (Bekare, 45)

Nota kaluese për çdo besimtar është mëshira dhe udhëzimi në rrugë të drejtë. Në Kur'an, Allahu i Lartësuar ka thënë: "Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë." (Bekare, 157)

E gjithë dobia nga ky provim është testi mi i njeriut në këtë botë: "Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që Allahu gjithqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën e do t'i dallojë edhe gënjeshtarët." (Ankebut, 3)

Të nderuar lexues!

Po ashtu, duhet kujtuar se besimi nuk është vetëm fjalë, e cila thuhet me gjuhë, por është vërtetësi me detyra, obligime dhe përgjegjësi.

Sprovat janë të dobishme; përmes tyre vihet në provë vullneti dhe sinqeriteti i besimtarëve; ato nxjerrin në shesh dhe ripërtërijnë besimin, hapin dhe shndrisin zemrat e besimtarëve. Shumë gjëra nuk do t'i dinte besimtari, po të mos sprovohej. Për më tepër,

nën klimën e sprovës një besimtar kalitet. Poeti el-Mutenebi thotë:

Më gjuajti koha me fatkeqësitë,

Deri sa pëlhura e zembrës m'u bë e hekurt.

Dhe u bëra, që kur të më godasin me shigjeta,

Të thyhen, mend si shigjetat të preknin njëra me tjetrën.

Dhe ja kështu jetova, e për fatkeqësitë as që u interesova

Ngase të mbaj mërzinë dobi nuk pata e as diçka fitova.

Testi provues nuk ka karakter aspak fyes dhe përdhosës, por është i natyrës verifikuese dhe korrigjuese, edukuese dhe reformuese.

"Dhe që Allahu t'i provojë (pastrojë) besimtarët (nga gjynahet) dhe t'i shkatër-

Më gjuajti koha me fatkeqësitë,
 Deri sa pëlhura e zemrës m'u bë e hekurt.
 Dhe u bëra, që kur të më godasin me shigjeta,
 Të thyhen, mend si shigjetat të preknin njëra me tjetrën.
 Dhe ja kështu jetova, e për fatkeqësitë as që u interesova
 Ngase të mbaj mërzinë dobi nuk pata e as diçka fitova.

rojë mosbesimtarët." (Ali Imran, 141)

Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem ka thënë: "E çuditshme është çështja (gjendja) e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askënd tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (Allahun), e kjo i sjell dobi. E kur e godet e keqja, ai është durimtar andaj kjo i sjell dobi (shpërblim)". (Transmeton Muslimi)

Njerëzit më të sprovuar ishin të dërguarit e Allahut të Lartësuar, meqë ishin më të paluhatshmit në misionin e shenjtë thirrës. Sad b. Ebi Vekasi e pyet

Muhamedin, salallahu alejhi ue selem: "Cilët njerëz janë më të sprovuar", dhe ai përgjigjet: "Njerëzit më të sprovuar janë pejgamberët, pastaj ata që janë më afër tyre dhe që i ndjekin ata. Sprovohet njeriu sipas shkallës së besimit, nëse është i fortë në besimin e tij edhe sprovën e ka më të madhe. Nëse është i dobët në besimin e tij do të sprovohet sa shkalla e besimit të tij. Njeriu sprovohet derisa të ecë mbi tokë pa asnjë mëkat. (Transmeton Tirmidhiu, hadithi është sahih).

Kështu do të testohen besimtarët, Allahu Fuqiplotë i sprovon ata që i do nga të devotshmit, por çdo herë duhet të jenë në gatishmëri dhe të qëndrueshëm, porsidega që luhatet nga era djathtas dhe majtas, por sërish mbahet.

O njeri! Kërko mbështetje tek Allahu i Lartësuar dhe duro. Asnjëherë mos u ligështohet dhe mos u dobëso.

Besimtarët, të dashurit e Allahut, janë të kënaqur dhe durimtarë me çdo caktim të Allahut të Lartësuar; nuk janë aspak të frikësuar, as të dëshpëruar. Të kujtojmë së bashku fjalët e Allahut të Lartësuar:

"Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? (Ata janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të ruajtur. Atyre u jepet myzhde në jetën e Dynjasë (në çastin e vdekjes) dhe në jetën tjetër (për shpëtim dhe xhenet). Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim. E, ai është sukses i madh." (Junus, 62-64)

"E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) deri sa ju jeni më të lartit, po që se jeni besimtarë të sinkertë." (Ali imran 139)

Vendi për
 reklamën tuaj

Artikuj

Ndërmjetësimi - tek Allahu dhe te njerëzit

Shkruan: Salih b. Feuzan EL-FUZZAN

Shumë njerëz kanë kuptim të gabuar në këtë çështje, gjë e cila shumë prej tyre i ka dërguar në mosbesim dhe lajthitje. Dy njerëz polemizonin dhe njëri prej tyre tha: Doemos duhet të kemi ndërmjetësues mes neve dhe Allahut, sepse nuk mundet të arrijmë tek Ai pa ndërmjetësues! Për këtë fjalë u pyet dijetari Ibën Tejmije, Allahu e mëshiroftë, i cili u përgjigj:

Nëse ka për qëllim ndërmjetësuesin i cili na kumton ligjin e Allahut - kjo është e vërtetë. Sepse krijesat nuk e dinë se çka dëshiron Allahu dhe cilat vepra e kënaqin Atë, nuk e dinë çka ka urdhëruar dhe çka ka ndaluar, nuk dinë çka ka përgatitur me Bujarinë e Tij për miqtë e Tij dhe me dënimin e Tij për armiqtë e Tij. Krijesat nuk e dijnë se cilat emra të bukur dhe cilat cilësi të larta janë meritore për Allahun. Për shkak se mendja dhe logjika nuk ka mundësi t'i njohë këto dhe të ngjashmet me këto përveçse me të dërguar që i ka dërguar Allahu. Andaj, ata që u besojnë pejgamberëve dhe shkojnë pas tyre, ata janë të udhëzuar dhe janë të afruar tek Allahu. Ata do të

ngrihen në shkallë të larta dhe do të gëzojnë nderimin në dynja dhe ahiret. Ndërsa kush i kundërshton të dërguarit, ata janë të mallkuar, të humbur dhe të privuar nga Zoti. Ai ka thënë: "O bijtë e Ademit, juve ju vijnë të dërguar nga mesi juaj, ua përkujtojnë faktet e Mia (shkoni pas tyre). E kush ruhet dhe përmirësohet, për ta s'ka as frikë as s'kanë përse të pikëllohen. E ata që i konsideruan të rreme faktet tona dhe me kryelartësi u larguan prej tyre, ata janë banues të zjarrit dhe në të janë përjetë". (A'raf 35, 36); "Kur tu vijë nga Unë udhëzim, kush i përmbahet udhëzimit Tim, ai nuk ka për të humbur e as nuk ka për të dështuar. E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në ditën e kiametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: "Zoti im, përse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?" Allahu thotë: "Ashtu si i harrove ti argumentet Tona që t'i ofruam, ashtu ti je i harruar sot". Ibën Abbasi ka thënë: Allahu garanton se kush e lexon Kur'anin dhe vepron sipas tij, nuk do të pësojë humbje në këtë botë e as nuk do të dështojë në botën tjetër.

Allahu garanton se kush e lexon Kur'anin dhe vepron sipas tij, nuk do të pësojë humbje në këtë botë e as nuk do të dështojë në botën tjetër.

dërguarin, ai e ka respektuar Allahun"; "Nëse vërtetë e doni Allahun, ecni pas meje, atëherë Allahu do t'ju dojë juve".

Pas kësaj, dijetari e sqaroi llojin tjetër të ndërmjetësimit, të cilin kush e pohon del nga feja. Ai tha: Nëse me fjalën ndërmjetësim ka për qëllim se është patjetër të kemi ndërmjetësues në sjelljen e të mirave dhe largimin e të këqijave, si p.sh. të jetë ndërmjetësues për të sjellë riskun, ndihmën apo udhëzimin dhe si pasojë e kësaj, të luten ata persona (ndërmjetësues) apo të shpresohen, kjo është shirku (idhujtaria) më i madh, me të cilin Allahu i quajti kafira idhujtarët (mushrikët). Sepse ata, besonin në ndërmjetësues, nëpërmjet të cilëve kërkonin të mirat dhe mbrojtje nga të këqijat.

Nga kjo përjashtohet ndërmjetësimi (shefati) të cilin e lejon Allahu për atë, me fjalën dhe punën e të cilit është i kënaqur Ai. Pra, ndërmjetësimi të cilin do ta lejojë Allahu është realitet që duhet besuar.

Pastaj tha: Kush i beson melekët dhe pejgamberët si ndërmjetësues, mbështetet tek ata dhe kërkon të mirat apo mbrojtje nga të këqijat, sikurse kërkimi i faljes së mëkateve, udhëzimit të zemrave, largimit të problemeve etj - ai është i pabesë me pajtimin e të gjithë myslimanëve. Ajetet që na e mësojnë këtë janë: "S'është e drejtë as nuk i takon asnjë njeriu që t'i ketë dhënë Allahu librin, urtësinë dhe pejgamberllëkun, e pastaj ai t'u thotë njerëzve: "Bëhuni robër të mi (më adhuroni mua) e jo të Allahut"! Por: "Bëhuni dijetarë të mësimave të Zotit, ngase u keni mësuar njerëzve librin dhe e keni studiuar atë. Dhe as t'ju urdhëron ai

(pejgamberi) që engjëjt, apo pejgamberët t'i konsideroni për zota. Vallë, do t'ju urdhërojë në mosbesimin pasi që ju jeni bërë myslimanë"? (Alu Imran 79, 80). Këtu na sqaron se konsiderimi e engjëjve dhe pejgamberëve si zota është kufër (mosbesim), andaj kush i konsideron engjëjt dhe pejgamberët si ndërmjetësues dhe mbështetet në ta, i lut dhe kërkon të mirat apo mbrojtje nga të këqijat, sikurse faljen e mëkateve apo udhëzimin, ai njeri është jobesimtar me pajtimin e gjithë myslimanëve.

Ndërsa përveç pejgamberëve, sikurse dijetarët, kush i pohon ata si ndërmjetësues midis pejgamberit dhe besimtarëve, të cilët do të kumtojnë dijen, do t'ua mësojnë të tjerëve, do t'i edukojnë - kjo është e vërtetë. Kur dijetarët janë unanim për një çështje, pajtimi i tyre është argument i prerë. Nuk mund të bashkohen në të pavërtetë, e nëse nuk pajtohen për diçka, atë çështje ia referojnë Allahut dhe të dërguarit, sepse individualisht, asnjëri prej tyre nuk është i pagabueshëm. Përkundrazi, fjala e secilit pranohet ose refuzohet, përveç fjalës së Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të.

Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve, mirëpo trashëgimia e pejgamberëve nuk është dinar as dërrhem, trashëgimia e tyre është dija, kush merr dijen ai ka marr diç të madhe". Pra, dijetarët me këtë kuptim mund t'i quajmë ndërmjetësues. Ndërsa, kush i beson si ndërmjetësues midis Allahut dhe krijesave, sikurse janë ndërmjetësuesit midis

Dallimi mes ndërmjetësuesve tek Allahu dhe te njerëzit

mbretërve/ kryetarëve dhe popullit dhe se ata janë kompetent t'i paraqesin nevojat e njerëzve para Allahut, ashtu që njerëzit t'i lusin ata, e ata ta lusin Allahun... kush i pohon me këtë kuptim ai është jobesimtar dhe politeist (mushrik). Në atë rast duhet të kërkohet pendim i shpejtë nga ai, përndryshe shteti Islam duhet ta vret, sepse ai ka bërë përngjasimin e krijesës me Krijuesin dhe i ka përshkruar Atij ortakë.

Kështu na e sqaroi ky dijetar i madh këtë çështje të rëndësishme - pohimin e ndërmjetësuesve - ku tregoi se ndërmjetësimi i të dërguarve mes Allahut dhe krijesave është ndërmjetësim për të kumtuar nga Allahu dhe detyrë e jona është t'i respektojmë në të.

Ndërsa, ndërmjetësimi i dijetarëve midis peygamberëve dhe njerëzimit është ndërmjetësim për të kumtuar dijen që ka ardhur nëpërmjet të dërguarve, sepse ata janë trashëgimtarë të peygamberëve.

Mirëpo, kush i konsideron peygamberët apo dijetarët si ndërmjetësues tek Allahu për kryerjen e nevojave apo pranimin e lutjeve ky është ndërmjetësim i rremë dhe kush e pohon ai nuk mund të jetë besimtar. Sepse, Allahu ndërmjet Tij dhe nesh nuk ka bërë të ligjshëm asnjë ndërmjetësues për kështje, madje ka gjykuar se nuk është mysliman kush beson ashtu. Ai ka thënë: "Ndërsa ata që në vend të Tij kanë zënë miq të tjerë dhe thonë: Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut, s'ka dyshim se Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që ata ishin në kundërshtim. E, është e vërtetë se Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë atë që është gënjeshtar, jobesimtar". (Zumer 3).

Allahu i di sekretet dhe ato më të fshehtat, Atij nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë apo në qiej. Ai Dëgjon dhe Sheh. Ai i dëgjon zhurmat e zërave, me gjuhët e llojllojshme dhe për nevojat më të ndryshme.

Dijetari Ibën Tejmije vazhdon dhe na sqaron dallimin e ndërmjetësimit që bëhet midis pushtetarëve dhe popullatës, me atë ndërmjetësim që ata e besojnë mes Allahut dhe krijesave. Ai thotë: Ata fillimisht e kanë përngjarë krijesën me Krijuesin, sepse ndërmjetësimet që ndodhin midis pushtetarëve dhe popullatës janë tre sish:

- për t'i lajmëruar se çka ndodhë në mesin e popullatës. E kush thotë se Allahu nuk di çka ndodhë te krijesat e Tij përderisa të lajmërohet nga dikush (ndërmjetës), qoftë ai melek, peygamber apo dikush tjetër, ai me këtë besim është jomysliman. Përkundrazi, Allahu i di sekretet dhe ato më të fshehtat, Atij nuk mund t'i fshihet asgjë në tokë apo në qiej. Ai Dëgjon dhe Sheh. Ai i dëgjon zhurmat e zërave, me gjuhët e llojllojshme dhe për nevojat më të ndryshme. Nuk e angazhon dëgjimi i diçkaje nga dëgjimi i diçka tjetër. Atij nuk i përzihen çështjet e as nuk mërzhitet nga lutjet e tepërta.

- pushtetari të jetë i pamundshëm në rregullimin e çështjeve të qytetarëve dhe mbrojtjen e tyre nga armiqtë, po nuk i doli dikush në ndihmë. Pra, për shkak të pamundësisë dhe dobësisë ka nevojë për ndihmë dhe ndihmëtarë. Allahu i Lartmadhëruar nuk ka nevojë për përkrahje e as për ndihmëtar. Ai ka thënë: "Thuaj: Thirrni ata, për të cilët supozuat se janë zota pos Allahut! Ata nuk posedojnë as sa një grimcë në qiej e as në tokë dhe as që kanë në to ndonjë pjesë, dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë përkrahje". (Sebe 22); "Dhe thuaj: Falënderuar qoftë Allahu, i cili nuk ka

fëmijë dhe nuk ka për Të shok në sundim, dhe sa i përket aftësisë, nuk ka nevojë për ndihmëtarë, dhe madhëroje Atë me madhërinë që i takon". (Zumer 111). Çdo gjë që gjendet në gjithësi, Allahu është Krijuesi, Zoti dhe Poseduesi i saj. Ai është i Pasuri dhe i panevojshëm nga çdo gjë, ndërsa çdo gjë tjetër është e varfër dhe e nevojshme për Të. Gjë të cilën nuk e gëzojnë pushtetarët, të cilët vazhdimisht kanë nevojë për përkrahës, të cilët në realitet janë edhe pjesëmarrës në atë pushtet. Allahu i Lartësuar nuk ka asnjë ortak (pjesëmarrës) në pushtetin e Tij. Shkurt, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Tij, të vetmit i Cili nuk ka ortak, Atij i takon pushteti dhe i gjithë falënderimi. Mbi çdo gjë, Ai është i Gjithëfuqishëm.

- pushtetari të mos dëshirojë të mirën, bamirësinë dhe mëshirën për popullatën, ashtu që ka nevojë të nxitet nga dikush tjetër (ndërmjetësues). Pasi që ta nxisë këshilltari i tij me këshilla dhe fjalë miradije, apo e lajmëron se dikush konkretisht e respekton dhe e nderon shumë atë pushtetar, vetëm në atë rast dëshira dhe ambicia e pushtetarit ngjallet për të bërë ndonjë të mirë për popullatën. Dhe atë, ose për shkak të fjalëve prekëse nga këshilltari ose për shkak të shtimit të respektit dhe nderit te popullata.

Mirëpo Allahu është Zot dhe Posedues i çdo gjëje, Ai ka mëshirë për krijesat më shumë sesa nëna për fëmijën, të gjitha gjërat ndodhin me vullnetin e Tij, çka dëshiron Ai bëhet, e çka jo - nuk bëhet. Ai ka bërë që krijesat të kenë dobi nga njëri - tjetri, ky i bën mirë atij, lutet për të, i ndihmon etj. Ai e krijoi të gjithë këtë, Ai e krijoi në zemrën e këtij bamirësi dëshirën për

Askush në gjithësi, nuk ka mundësi ta detyrojë Allahun të bëjë ndryshe nga ajo që Dëshiron Ai, ta këshillojë dikush apo ta lajmërojë se kush e lut dhe e respekton Atë.

bamirësi, lutje dhe ndihmë.

Askush në gjithësi, nuk ka mundësi ta detyrojë Allahun të bëjë ndryshe nga ajo që Dëshiron Ai, ta këshillojë dikush apo ta lajmërojë se kush e lut

dhe e respekton Atë. Prandaj, i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Askush nga ju mos thoni: O Allahu im, nëse do, më fal mua. O Allahu im, nëse do, më mëshiro mua. Bëhuni të vendosur në lutjet tuaja, sepse Allahun s'mundet ta detyrojë askush".

Ndërmjetësuesit e vërtetë janë ata që do të ndërmjetësojnë vetëm me leje të Allahut. Këtë na e mëson Allahu i Lartësuar me ajetet: "E kush do të ndërmjetësojë tek Ai, përveç se me lejen e Tij"; "nuk do të ndërmjetësojë përveç me të cilin është i kënaqur Allahu".

Gjë që nuk gjendet te pushtetarët, meqë tek ata ndërmjetësuesi duhet të jetë i pasur, pjesëmarrës në pushtet apo përkrahës dhe ndihmëtar i atij pushtetit. Dhe këta, ndërmjetësojnë te pushtetarët edhe pa leje dhe ata e pranojnë atë ndërmjetësim sepse kanë nevojë për atë, frikohen nga ata apo për t'i shpërblyer ata.

Allahu nuk shpreson nga askush, nuk ka frikë dhe nuk ka nevojë për askënd sepse Ai është i Pasuri. Allahu i Lartësuar thotë: "Ta keni të ditur se gjithçka që është në qiej e në tokë janë të Allahut. E ata (idhujtarët), që pos Allahut adhurojnë, nuk janë duke pasuar zota të vërtetë, ata nuk janë duke pasuar tjetër pos supozimeve dhe ata vazhdimisht gënjejnë". (Junus 66).

Idhujtarët, duke u bazuar në ndërmjetësimin që e njohin në këtë botë - d.m.th. te pushtetarët - në atë formë mendojnë se është edhe ndërmjetësi-

mi tek Allahu. Allahu i Lartësuar thotë: "Ata pos Allahut adhurojnë çdo gjë që nuk bën dëm e as dobi, dhe thonë: Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu!. Thuaj: "A ju po e informoni Allahun me diçka që Ai nuk e ditka në qiej dhe në tokë? I pastër (nga çdo e metë) dhe I Lartë është Ai nga ajo që i përshkruajnë ata". (Junus 18). Allahu na rrëfen se ata idhujtarë kanë thënë: "Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut". (Zumer 3).

Më pas na sqaroi ky dijetar rreth lutjes së krijesave njëri - tjetrin për ndërmjetësim (shifat), duke thënë se kjo lloj lutje ka kushte. Dhe atë: personi për të cilin bëhet lutja të jetë mysliman e jo idhujtar dhe lutësi të bëjë lutje të lejuara.

Nuk ka dyshim se lutja e krijesave për njëri tjetrin është e dobishme dhe për këtë jemi të urdhëruar. Mirëpo lutësi apo ndërmjetësuesi ka të drejtë të bëjë lutje dhe ndërmjetësim vetëm ku ka lejuar Allahu. Nuk lejohet të ndërmjetësojë aty ku ka ndalesë, sikurse ndërmjetësimi për idhujtarët apo lutja që atyre tu falen mëkatet. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Nuk ka të drejtë Pejgamberi e as besimtarët të kërkojnë falje për idhujtarët, edhe nëse janë të afërmit të tyre, pasi që u bë e qartë se me të vërtetë ata (idhujtarët) janë banorë të xhehenemit. Edhe lutja e Ibrahimit për babanë e vet nuk ishte tjetër, pos për shkak të një premtimi që ia pat premtuar atij, e kur iu bë e qartë se ai është armik i Allahut, u largua prej tij". (Teube 113-14).

Po ashtu është vërtetuar se Allahu ia ka ndaluar Muhamedit të lutet për idhujtarët dhe dyfytërësit dhe ka

lajmëruar se atyre nuk ua falë, nëse nuk pendohen. Allahu ka thënë: "Mos u lut për asnjërin prej tyre kur të vdesin dhe mos qëndro pranë varreve të tyre, sepse ata e kanë mohuar Allahun, të dërguarin dhe kanë vdekur duke qenë të prishur". (Teube 84). Po ashtu ka thënë: "Luteni Zotin tuaj të përulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që i kalojnë kufijtë (në lutje)". (A'raf 55). Kalimi i kufijve në lutje është kërkimi nga Allahu diçka që nuk do ta bënte asnjëherë. P.sh. të kërkojë të jetë në shkallë të pejgamberëve ndërsa ky nuk është i tillë, të kërkojë falje për idhujtarët apo të kërkojë gjëra të cilat janë mëkat, sikurse kërkimi i ndihmës për të bërë gabime dhe mëkate.

"Mos u lut për asnjërin prej tyre kur të vdesin dhe mos qëndro pranë varreve të tyre, sepse ata e kanë mohuar Allahun, të dërguarin dhe kanë vdekur duke qenë të prishur".

Pra, secili që lutet është edhe ndërmjetësues. Lutja dhe ndërmjetësimi ndodhë me caktimin dhe dëshirën e Allahut të Lartësuar. Allahu është që u përgjigjet lutjeve dhe pranon ndërmjetësimin.

Ai e ka krijuar shkakun dhe pasojën. Lutja është një prej shkaqeve të cilat i ka caktuar Allahu i Lartmadhëruar. Pasi qenka kështu, duhet ta dimë se mbështetja e plotë në shkaqe konsiderohet shirk në njësimin e Allahut, mos marrja në konsideratë e shkaqeve është e metë mentale, ndërsa mospërfillja e tyre në tërësi është nënçmim për sheriatin.

Përkundrazi, është e detyrueshme që besimtari të mbështetet, ta lutë dhe të kërkojë vetëm te Allahu i Lartësuar, ndërsa Allahu është Ai i cili ia mundëson shkaqet.

Përktheu: Omer BERISHA

Të folurit gjatë namazit

Përgatiti: Alaudin ABAZI

Në fillim, kur u obligua namazi, nuk ishin të ndaluara bisedat të cilat nuk kishin të bënin me namazin sikurse përsëritetja me selam, kthimi i saj, etj. Por më vonë, pasi kaloi një kohë nga obligimi i namazit, u ndaluan të gjitha bisedat që nuk kishin të bënin me të. Prandaj, juristët islamë, kur e shtjellojnë këtë problematikë, theksojnë se ekziston konsensus (ixhma), që nëse flasim në namaz qëllimisht, atëherë namazi prishet dhe nuk pranohet.

Por, nëse ndodh të flasim në namaz nga harresa ose nëse dalim nga namazi duke menduar se e kemi përfunduar atë dhe flasim, atëherë a konsiderohet namazi i prishur apo jo? Fukahatë në këtë çështje kanë dy mendime.

Mendimet e fukahave në këtë:

1. Shumica e dijetarëve (medhhebi Maliki, Shafi dhe Hanbeli) janë të mendimit se, nëse flasim në namaz nga harresa, ose nëse flasim duke menduar se e kemi përfunduar atë dhe japim selam para kohe, namazi nuk prishet.

2. Fukahatë e medhhebit Hanefi janë të mendimit se, namazi konsiderohet i prishur, pa marrë parasysh a kemi folur në namaz qëllimisht ose nga harresa dhe ne duhet ta përsërisim atë nga fillimi.

Argumentet e të dy palëve:

Argument bazë i mendimit të parë është hadithi që është i njohur te juristët islamë si "Hadithi i Dhuljedejnit (Dorëgjatit)".

Transmetohet nga Ebu Hurejra se Resulullahu, salallahu alejhi ve selem, me një rast, fali njërin nga dy namazet e pasditës (drekën ose ikindinë) dhe pas dy rekateve dha selam (derisa namazi ishte katër rekatësh), pastaj u ul në xhami para njerëzve, ku ndër ata që u falën, ishte Ebu Bekri dhe Omeri, por ngurruan të flasin dhe pyesin. Njerëzit filluan të dalin nga xhamia, duke u pyetur: a u shkurtua namazi? Një njeri, që i Dërguari i Allahut e quante Dhuljedejn, pyeti: "O i Dërguar i Allahut, a u shkurtua namazi apo harrove?" Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, u përgjigj: "As nuk u shkurtua as nuk kam harruar." Ai tha: "Jo, ke harruar." I Dërguari pyeti se a është duke e thënë të vërteten Dhuljedjeni. Ata që ishin të pranishëm iu përgjigjën se po. Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, i plotësoi dy rekatet të cilat nuk i kishte falur, dha selam, pastaj i bëri dy sexhde si ato të mëparshmet dhe prapë dha selam. (Shënon: Buhariu dhe Muslimi)

Nëse ndodh të flasim në namaz nga harresa ose nëse dalim nga namazi duke menduar se e kemi përfunduar atë dhe flasim, atëherë a konsiderohet namazi i prishur apo jo?

Argumentimi me këtë hadith është mjaft i qartë, Muhamedi, bekimi dhe paqja qofshin mbi të, e plotësoi namazin me dy rekate të tjera, pasi kishte dhënë selam para se ta përfundonte atë nga harresa dhe ai kishte

folur ndërmjet kësaj. Ekzistojnë edhe disa hadithe tjera që e vërtetojnë se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem ka dhënë selam nga harresa para kohe dhe ka folur pastaj e ka vazhduar namazin aty ku e ka ndërpreur, pasi i është tërhequr vërejtja.

Pastaj ata argumentojnë edhe me hadithin e Muavije b. Hakemit. Ku thotë: "Derisa falesha me të Dërguarin e Allahut, njëri nga të pranishmit (në namaz) teshtiu dhe unë i thashë: "Jerhamukellah

(Allahu të mëshiroftë)". Njerëzit filluan të më shikojnë duke zgurdulluar sytë (në shenjë qortimi për këtë vepër). Unë u thashë: "Çfarë keni që më shikoni?" Ata filluan t'i mëshojnë me duar kofshëve dhe kur vërejta se më qortojnë pse kam folur, heshta. Pasi përfundoi Profeti, bekimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të, namazin, vallahi nuk kam parë mësues më të mirë se ai, as më para as më pas. Ai as nuk më qortoi, as nuk më rrahu, as nuk më fyeu, por më tha: "Ky është namaz dhe nuk lejohet në të diç nga bisedat e njerëzve, namazi është për tesbih (lavdërim për Allahun), për tekbir (madhërim i Allahut) dhe lexim i Kur'anit." (Shënon Muslimi, Ahmedi, Nesaiu, Ebu Davudi).

Me këtë argumentohet se Muavije b. Hakemi ka folur në namaz nga mosdija për ndalimin e saj. Kurse Resulullahu nuk e urdhëroi ta përsërisë namazin për këtë. E njëjta vlen edhe nëse njeriu flet nga harresa ose nga mendimi se ai ka përfunduar namazin, ndërkohë që, në realitet, nuk e ka përfunduar. Pra, dijetarët argumentojnë me këtë hadith duke bërë analogji (kijas) mos njohjen e dispozitës me harresën.

Kurse argument i mendimit të dytë, i atyre që thonë se namazi prishet nëse flasim nga harresa, është hadithi i Abdullah b. Mesudit i cili thotë: "Në fillim e përshëndetnim (i jepnim selam) Resulullahun, salallahu alejhi ve selem, duke qenë në namaz dhe ai na e kthente atë. Pasi u kthyem nga Nexhashiu (nga Etiopia), (me një rast) i dhashë selam (duke qenë ai në namaz), e ai nuk ma ktheu, pastaj unë i thashë: "O i Dërguar i

Me këtë formë të shpjegimit të haditheve vihet në dispozicion të punuarit me të gjitha hadithet pa e anuluar asnjërin nga ato dhe kjo është më primare

Allahut (më herët) të jepnim selamin dhe ti na e ktheje atë duke qenë në namaz". Ai tha: "Me të vërtetë në namaz ka preokupime tjera" (Shënon Buhariu, Muslimi dhe të tjerët).

Dhe, argument tjetër gjithashtu, është hadithi i Zejd b. Erkam ku thotë: "Në fillim gjatë namazit ne flisnim, njëri nga ne i fliste shokut të tij që e kishte afër në namaz. Kur zbriti ajeti "...dhe ndaj Allahut të jeni respektues (në namaze)" (Bekare 237). U urdhëruam të heshtim dhe u ndalua nga biseda." (Shënon Muslimi).

Këto dy hadithe janë argument se biseda e prish namazin dhe juristët islamë, të cilët i përmendin këto hadithe si argument, sqarojnë se dispozita që nxirret nga këto është e përgjithshme qoftë qëllimisht apo nga harresa dhe ata nuk bëjnë dallim ndërmjet këtyre rasteve.



Fukahatë, të cilët kanë thënë se namazi priset në përgjithësi qoftë nëse flasim qëllimisht ose nga harresa, u janë përgjigjur argumenteve të mendimit tjetër se ato hadithe me të cilat kanë argumentuar ata janë të hershme dhe janë të anuluar (mensuh), me hadithet tjera (që këta argumentojnë me to), pasi në fillim ishte e lejuar biseda në namaz pastaj u ndalua. Prandaj, ata thonë se hadithi i Dhuljedejnit dhe ai i Muavijes (të cilat u përmendën më lart) kanë ndodhur para se të ndalohet biseda në namaz, pastaj kjo u ndalua më vonë dhe ato konsiderohen të anuluar (deroguar).

Mirëpo, ajo që llogaritet e saktë këtu është se këto hadithe, hadithi i Dhuljedejnit dhe Muavije Ibën Hakemit, janë më të vonshme se hadithi i Abdullah b. Mesudit dhe Zejd b. Erkamit (me të cilat kanë argumentuar ata që thonë se namazi priset nëse flasim në të, qoftë qëllimisht ose nga harresa). Hadithi i Dhuljedejnit dhe i Muavijes janë pas hixhretit, kurse hadithi i Abdullah b. Mesudit padyshim ka qenë para hixhretit pasi të gjithë pajtohen në mendimin se Ibën Mesudi është kthyer nga Abesinia (Etiopia) para hixhretit. Gjithashtu edhe hadithi i Zejd b. Erkamit është i hershëm. Këto dy hadithe (i Abdullah b. Mesudit dhe ai i Zejd b. Erkamit) tregojnë se në fillim kur është obliguar namazi, nuk ishte e ndaluar biseda, që duke u falur të flasësh me atë që e ke afër, kthimi i selamit, etj., e më pas këto ndalohen. Por kjo ndalesë ka ndodhur pa dyshim para hixhretit, ashtu si aludohet qartë kjo nga hadithi i Ibën Mesudit. Për këtë është i paqëndrueshëm pretendimi se ky hadith (i Ibën Mesudit) të jetë anulues (nasih) i hadithit të Dhuljedejnit, pasi ngjarja që tregohet në këtë hadith (të Dhuljedejnit) ka ndodhur në Medinë pas hixhretit. Për të qenë e mundur anulimi i një hadithi është e

detyrueshme që ky anulim të bëhet me një citat që është më i vonshëm se i pari.

Prandaj edhe një herë e theksojmë se hadithi i Ibën Mesudit dhe Zejd b. Erkamit kanë të bëjnë nëse flasim qëllimisht në namaz, e jo nga harresa. Kurse hadithi i Dhuljedejnit dhe i Muavijës janë më të vonshëm dhe kanë të bëjnë nëse flasim nga pavetëdija, ose nga harresa. Me këtë formë të shpjegimit të haditheve vihet në dispozicion të punuarit me të gjitha hadithet pa e anuluar asnjërin nga ato dhe kjo në shkencën e Usuli Fikhut, pra, të punuarit me të gjitha hadithet që kanë të bëjnë me një çështje duke mos lwnw anash ndonjërin prej tyre, është më primare, sesa të anulohet ndonjëra nga ato.

Çfarë duhet të veprojme nëse flasim në namaz nga harresa

Pasi kuptuam qëndrimet e fukahave në këtë dhe vlerësuam se qëndrimi më i avancuar dhe i qëndrueshëm në këtë është se nëse flasim me harresa, namazi nuk priset dhe nuk është e nevojshme të përsëritet ai nga fillimi, atëherë na mbetet të sqarojmë se çfarë duhet të veprohet në atë rast.

Për të qenë më i lehtë kuptimi i kësaj problematike do të bëjmë ndarjen e çështjes në dy raste të mundshme, ku myslimani mund të flasë në namaz nga harresa:

a) Nëse duke u falur, nga harresa e shqipton ndonjë fjalë që nuk është pjesë e namazit ose edhe i flet dikujt pa qenë i vetëdijshëm se është në namaz.

b) Të japë selam ai që është duke u falur, para përfundimit të namazit, nga harresa (qoftë edhe para përfundimit të të gjitha rekateve) dhe të mendojë se e ka kompletuar namazin të tërin ashtu si është e kërkuar dhe fillon të flasë, t'i thotë lutjet, ta bëjë dhikrin, ose të bisedojë me dikë që e ka.

Për rastin e parë, themi: nëse kjo bëhet me qëllim, namazi priset dhe është i papranuar, ashtu siç vërtetohet në hadithin e Zejd b. Erkamit që e transmeton Muslimi

Por, nëse flasim nga harresa se jemi në namaz, ose na shpëton nga goja ndonjë fjalë pa qëllim, atëherë mendimi më i saktë është se namazi nuk prishet, por është i obliguar të bëjë sehvi sexhde pasi këto fjalë nuk kanë të bëjnë me namazin .

Për rastin e dytë (nëse jep salam para përfundimit të namazit dhe flet), themi gjithashtu se, nëse kjo bëhet me qëllim, atëherë namazi është i papranuar dhe duhet të përsëritet nga fillimi.

Kurse, nëse kjo ndodh nga harresa, p.sh. nëse jep salam në rekatën e dytë duke menduar se e ka përfunduar namazin, por realisht atij i kanë ngelur edhe një ose dy rekate për t'i falur (nëse është në namazin e drekës ose të akshamit). Atëherë shikojmë, nëse koha prej daljes nga namazi deri kur i kujtohet është e gjatë, ose ka dal nga xhamia dhe ka kaluar një kohë, ose e ka prishur abdesin, ai namaz është i papranuar dhe duhet ta përsërisë nga fillimi, pasi që nuk është e mundur ta plotësojë namazin të cilin e ka lënë të mangët dhe ka kaluar kohë shumë.

Nëse koha nuk është e gjatë, atëherë ai e plotëson namazin (edhe pse ai ka dhënë salam ose ka folur, qoftë edhe ka biseduar rreth ndonjë gjëje që nuk ka të bëjë me namazin), pastaj pasi e plotëson atë në fund të namazit bën sehvi sexhde dhe jep salam edhe njëherë. Argument për këtë është hadithi i lartpërmendur i Dhuljedgejnit të cilin e shënon Buhariu. Në këtë hadith kuptohet mjaft qartë se Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, ka dhënë salam nga harresa pasi ka falur vetëm dy rekate, pastaj e ka plotësuar atë edhe me dy rekate tjera për t'i bërë katër rekate pasi ishte namazi i drekës apo ikindisë. Muhamedi, sallallahu alejhi ve selem, ndërmyjet këtyre rekateve ka folur, megjithatë ai nuk e filloi namazin nga fillimi, por rekateve të mëparshme ia bashkëngjiti të tjerat për ta plotësuar tërë namazin.

Deumetul xhendel - ngjarja që ktheu krenarinë e Medinës

Shkruan: Semir HALEBI

Zemërimi i jomyslimanëve të Mekës nuk shuhej assesi, nga disfata që kishin pësuar prej myslimanëve në Bedër, ku u vranë shumë burra dhe trima të tyre. Shumë zullumqarë pësuan nga majat e shigjetave dhe shpatave të myslimanëve. Andaj, me padurim prisnin ndonjë rast që të hakmerreshin kundër Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dhe shokëve të tij, me shpresë që t'u shkaktonin humbje dhe

Temë

në atë mënyrë të largojnë turpin dhe nënçmimin që e kishin fituar nga disfata e madhe në Bedër.

Ky rast iu mundësua atyre në luftën e Uhudit, sidomos kur shigjetarët nuk respektuan urdhrin e Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, duke u larguar nga pozicioni i tyre në kodër. Halid b. Velidi atëbotë ishte në krye të kalorësve të Kurejshëve dhe kjo ishte një gjendje e përshtatshme për të që t'i rrethonte myslimanët dhe t'u shkaktonte disfatë. Ai arriti të ngjitet në kodër dhe të vriste shigjetarët e mbetur aty, pastaj e befaso i ushtrinë myslimane me sulm të ashpër. Kjo vërtet ishte një sprovë e rëndë, e cila shkaktoi humbje të dhimbshme, edhe pse gjatë luftimit u treguan të qëndrueshëm dhe trima. Sidoqoftë, befasia ishte e rëndë dhe e ktheu fitoren në anë të jomyslimanëve.

Myslimanët u kthyen në Medinë për të shëruar plagët e luftës dhe dëshpërimin e humbjes. Por, dhembjet e të plagosurve dhe qarjet e nënave as që krahasoheshin me të hidhurën e disfatës dhe me rënien e flamurit të myslimanëve në këtë betejë me mushrikët.

Kjo disfatë shkaktoi uljen e autoritetit të myslimanëve në Medinë karshi çifutëve dhe mushrikëve të tjerë, të cilët me shumë kujdes prisnin të gëzoheshin me zhdukjen e shtetit të myslimanëve në Medinë. Mirëpo, sërish nuk kishin guxim t'i shprehnin këto ndjenja dhe këtë armiqësi para myslimanëve.

Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, mjaft mirë e vërente këtë mërzë dhe ndjenjat e mposhtjes në gjokset e besimtarëve. Edhe pse, Allahu kishte zbritur ajetin:

"Në qoftë se juve u goditi çka u dhemb (në Uhud), edhe atë popull (armikun) e pat prekur një dhembje si kjo e juaja (në Bedër). Këto janë vetëm ditë, që i ndërrojmë mes njerëzve, për t'u njohur tek Allahu ata që i besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë (shehida). Allahu nuk i do zulumqarët". (Alu Imran 140). Mirëpo, zemrat dhe ambiciet e besimtarëve dëshironin të liroheshin nga kjo mërzë dhe ta tejkalonin këtë mposhtje duke e shfaqur forcën dhe duke nxjerrë në pah krenarinë e tyre kundër armiqve në përgjithësi. Qofshin ata të brendshmit (në Medinë) apo të jashtmit (Kurejshët dhe fiset tjera arabe që ishin mushrikë).

Fushatat e çifutëve dhe tradhtia e marrëveshjes me të dërguarin e Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të

Dëshirën që kishin besimtarët e kishte edhe i dërguari i Allahut, t'i bindin armiqtë e tyre se

myslimanët ishin ende të fuqishëm dhe mbanin ende krenarinë për të rikthyer pozitën dhe namin që kishin tek arabët tjerë dhe te çifutët.

Mes myslimanëve dhe çifutëve që banonin në Medinë kishte marrëveshje, në të cilën u pajtuan të dy palët që nga hyrja e parë e Resulullahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, në Medinë. Ajo marrëveshje siguronte lirinë e besimit dhe të adhurimit për të dy palët. Po ashtu, me anë të asaj marrëveshjeje, gjithë banorët e Medinës detyroheshin ta mbronin qytetin në rast të çdo rreziku apo sulmi.

Mirëpo, ëndja e çifutëve për ta pat Medinën të tyren dhe edukata e tyre plot dredhi, tradhti dhe mashtrime, bëri që ata të organizohen kundër të dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i



Allahut qoftë mbi të.

Tentuan ta vrasin dhe të lirohen nga ai dhe thirrja e tij. Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, mori vesh për këtë fushatë që udhëhiqej nga fisi Beni Nadir (fis çifut) dhe atë, me lajmërim nga Allahu i Lartësuar.

Prandaj, Resulullahu paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, dha urdhër që fisi Benu Nadir ta braktisin Medinën menjëherë, me qëllim që në qytet të rikthehej siguria dhe qetësia. Kështu myslimanët shpëtuan nga dredhitë dhe fushatat e çifutëve dhe patën fatin t'i gëzojnë pasuritë dhe kopshtet e çifutëve.

Ndërkohë, u mor vesh se edhe mushrikët e Mekës kishin vendosur të ndesheshin me myslimanët me një ushtri të madhe. Andaj, edhe i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, i

bëri gati afër 1000 kalorës dhe doli sërish në Bedër për t'u ndeshur me ta, ndërsa në Medinë la përgjegjës Abdullah b. Abdullah b. Ubej b. Selul. Mekasit u nisën nën udhëheqjen e Ebu Sufjanit me afro 2000 kalorës. Mirëpo, pasi bënë një udhëtim dy ditësh Ebu Sufjani vendosi të kthehet së bashku me shokët e tij, ndërsa Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të,

Nuk u interesonte a do të vdesin apo do të mbijetonin; besimi i tyre në Allahun dhe të dërguarin e Tij ishte shtytës për tejkalimin e të gjitha vështirësive. Këtë e bënë në respekt për Allahun dhe përgjigje ndaj kërkesës së Resulullahut, salallahu alejhi ue selem. Besimi i fortë i tyre i lëvizte drejt triumfit dhe fitores.

dhe shokët e tij qëndruan duke pritur tetë ditë me radhë, ku kohë pas kohe bënë disa aktivitete tregtare dhe fituan mjaft pasuri. Pastaj u kthyen në Medinë, ku kishte ardhur lajmi se Mekasit ishin tërhequr dhe kishin ikur nga ballafaqimi me myslimanët në Bedrin e dytë. Çka u ktheu myslimanëve vetëbesimin dhe qetësinë, dhe solli, po ashtu, krenarinë e dikurshme dhe ngriti personalitetin e tyre te të tjerët.

Nuk shkoi shumë kohë, dhe lajmi se fiset e vendit "Deumetul Xhendel" ishin tubuar që të përgatiten për luftë kundër myslimanëve mori dhenë. Në fakt, edhe kohë më parë, syresh sulmonin karvanët që kalonin pranë tyre, keqtrajtonin ata që u afroreshin tokave të tyre, pengonin tregtinë, grabitnin pasurinë dhe vrisnin këdo që i kundërshtonte. Ata u bënë rrezik serioz për karvanët e tregtarëve që vinin në Medinë, të cilët ishin mjaft të rëndësishëm për atë vend.

Andaj, Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, dha shenjë se besimtarët duhet të mblidheshin për t'i luftuar këto fise, me qëllim që të ndalnin të tjera zullume, duke synuar të eliminonin rreziku që po i kanosej Medinës. U bënë 1000 myslimanë dhe u nisën për në Deumetul Xhendel, ndërsa në Medinë përgjegjës u caktua Sibaë b. Urfuta el-Gifari.

Ishte rrugë e gjatë dhe e rëndë, shkretëtirë e thatë dhe shumë e nxehtë. Duhej të udhëtonin afër 300 km për të arritur në Deumetul Xhendel, në veri të Gadishullit Arabik. Për këtë rrugë i dërguari i Allahut zgjodhi edhe një udhëheqës rruge nga familja Adhra, i cili quhej Medhkur. Ai kishte mençuri të dalluar, shkathtësi të paparë, përvojë të madhe dhe njohuri për kushtet, rrugët e fshehta dhe vështirësitë e shkretëtirës.

Vazhduan rrugëtimin nëpër shkretëtirën e thatë dhe të rëndë, nuk ia venin veshin vështirësive dhe problemeve të rrugës, duronin temperaturën e lartë, thatësinë dhe mungesën e ujit. Nuk u interesonte a do të vdesin apo do të mbijetonin; besimi i tyre në Allahun dhe të dërguarin e Tij ishte shtytës për tejkalimin e të gjitha vështirësive. Këtë e bënë në respekt për Allahun dhe

Kjo betejë synonte të arrinte disa qëllime; ajo shëroi shpirtin e dobësuar të myslimanëve dhe nënçmimin që gati i goditi kur e humbën betejën në Uhud, ndihmoi të lirohen nga gjurmët e disfatës që pësuan, ndikoi në ngritjen e moralit dhe kthimit të vetëbesimit si dhe njëherazi shkatërroi moralin luftarak të ushtrisë armike.

përgjigje ndaj kërkesës së Resulullahut, salallahu alejhi ue selem. Besimi i fortë i tyre i lëvizte drejt triumfit dhe fitores.

Muhamedi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, me shokët e tij rrugëtonin gjatë natës ndërsa ditën fshiheshin, që të mos vëreheshin nga mushrikët (idhujtarët), çka mund t'i ndihnte fiset e Deumetul Xhendel të kuptonin se ai ishte nisur drejt tyre. Qëllimi ishte të arrinin atje përpara se armiku të përgatitej për betejë. Kjo arritje do t'i siguronte realizimin e elementit të kapjes në befasi të armikut.


Ky lloj rrugëtimi po ashtu u siguronte mbrojtje nga temperaturat e larta dhe nxehtësia e rërës, që të mos takohen me armikun me fuqi të harxhuar, të lodhur nga rruga dhe klima e nxehtë.

Fitore pa luftë

Kur u afruan myslimanët në Deumetul Xhendel, udhëheqësi i rrugës u tregoi se aty pranë kishte deve e dhen që kullosnin; ishin të disa njerëzve nga fisi Temim. Kështu që, shkuan dhe arritën të zinin disa kafshë, ndërsa shumica e kafshëve ikën dhe u shpërndanë në çdo anë.

Nga kjo, banorët e Deumetul Xhendel kuptuan se kanë ardhur myslimanët dhe shpejtuan për t'u arratisur, duke lënë shtëpitë dhe pasuritë, që të shpëtonin nga myslimanët.

Atëherë, Resulullahu salallahu alejhi ue selem, hyri në qytet dhe nuk gjeti



askënd. Aty u ndal disa ditë dhe vazhdimisht dërgonte ekspedita për të hulumtuar në çdo anë, mirëpo nuk gjenin asnjë njeri. Përveç një person, të cilin e kishte zënë Muhamed b. Mesleme dhe e solli te i dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të. Ku i ke shokët - e pyeti. Kanë ikur dje - u përgjigj. Resulullahu salallahu alejhi ue selem, i ofroi që ta pranonte Islamin dhe ai e pranoi.

Pasi qëndruan disa ditë atje, në datën 20 Rebiul Evvel, viti i 5 (18 Shtator 626 G) u kthyen në Medinë.

Shumë ushtarakë bashkëkohorë këtë ngjarje e quajtën operacion sulmues mbrojtës për shtetin Islam në Medinë. Sepse, Resulullahu, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, nuk priti që armiqtë ta befasonin me sulm kundër

Medinës, përkundrazi, shpejtoi kundër tyre posa kuptoi për planet e këqija.

Kjo betejë synonte të arrinte disa qëllime; ajo shëroi shpirtin e dobësuar të myslimanëve dhe nënçmimin që gati i goditi kur e humbën betejën në Uhud, ndihmoi të lirohen nga gjurmët e disfatës që pësuan, ndikoi në ngritjen e moralit dhe kthimit të vetëbesimit si dhe njëherazi shkatërroi moralin luftarak të ushtrisë armike.

Kjo betejë edhe më tepër i ngjau shfaqjes së fuqisë së shtetit Islam, gjë e cila do t'i shkatërronte dëshirat e armiqve kundër myslimanëve, duke i bashkëngjitur kësaj edhe shkatërrimin e projekteve grabitqare të armiqve dhe privimin e tyre nga realizimi i elementit të befasismit.

Zgjuarsia ushtarake e komandantit Pejgamber

Aftësia dhe zgjuarsia ushtarake e Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, nga kjo ngjarje shihet prej disa aspekteve:

- kujdesi paraprak nga rreziqet dhe njoftimi me lëvizjet, aktivitetet dhe planet ushtarake të armikut.

- Mosnënçmimi i armikut, përgatitja e mirëfilltë për betejë dhe kërkimi i ndihmës nga njerëzit me përvojë dhe kompetentëve në artet e luftës dhe kushtet e shkretëtirës.

- Sekretet e plotë dhe fshehja e përsosur që bëri duke rrugëtuat gjatë natës dhe nëpër rrugë jo të zakonshme dhe duke pushuar dhe u fshehur gjatë ditës.

- Kujdesi për të vërtetuar mbisundimin dhe për të lajmëruar fitoren pasi të ikin armiqtë, çka e bëri duke qëndruar një kohë më të gjatë në vendbanimet e armiqve që kishin ikur.

- Praktikimi i elementit të zënies në befasi të armiqve, duke i sulmuar në vendin e tyre dhe para se të përgatiten. Gjë e cila ndikon në arritjen e fitores.

Përktheu: Omer BERISHA

Si ta fitojmë dashurinë e bashkëshortes

Shkruan: Elvedin Peziq

Këshilla të arta për një martesë të lumtur dhe të suksesshme (1/2) Njerëzit kërkojnë lumturinë në martesë. Çdo njeri mendon se në martesë do të gjejë kënaqësi, harmoni, respekt, kuptueshmëri, përkrahje për në rrugë të vërtetë... Më pastaj, befasohet kur përballet me të vërtetën. Nga ky realitet, mjafton të flasim për këtë temë mjaft të rëndësishme. Nëse kësaj i shtojmë edhe faktin se njeriu kalon shumë kohë në shtëpi dhe se, nëse nuk ka një jetë bashkëshortore të rehatshme, kjo do të bëjë që ai mos të ndihet i qetë në shtëpi, e cila duhej të ishte oazi e prehjes, vend ku do të pushojë nga angazhimet e përditshme, strehim nga sfidat që e ndjekin në çdo hap...

Familja luan një rol shumë të madh për zhvillimin dhe funksionimin e drejtë të një shoqërie. Nëse familja funksionon drejtë, atëherë është për të pritur fryte cilësore nga kjo qelizë e rëndësishme e shoqërisë. Frytet më cilësore që mund të presim nga një familje që funksionon drejtë janë fëmijët e edukuar mirë, pikërisht ata, që nesër do të bëhen bartësit e kësaj shoqërie. Gjithë jetën mbi ta do të vërehen gjurmët e edukatës së familjes, qoftë në kuptimin pozitiv apo negativ. Fëmijë të edukuar mirë nuk do t'i shërbejnë vetëm vetes dhe famil-



jes, por edhe gjithë shoqërisë, e cila do ta ndjejë mirësinë e tyre. Fëmijë të edukuar keq nuk do t'i sjellin probleme vetëm familjes, por do të jenë problem edhe për gjithë shoqërinë. Për të dy kategoritë ekzistojnë shumë shembuj, që nuk është e nevojshme që t'i përmendim këtu. Një njeri me arsye të shëndoshë nuk dyshon për asnjë moment se burimi më i madh i problemeve bashkëshortore është mungesa e zbatimit të principeve islame në jetën e përditshme, në krye të së cilës qëndron Ligdhënësi.

**Më i miri ndër ju është ai,
i cili është më i mirë me gruan e vet**

Shpesh do të takojmë njerëz, të cilët, nga pamja e jashtme, duket sikur zbatojnë fenë në jetën e tyre të përditshme, porse, kur largohen nga sytë e publikut dhe hynë në shtëpi, jetojnë në një mënyrë krejt tjetër nga ajo që i njohin shokët dhe kolegët. Dëshmitarë më të mirë janë gruaja dhe familja e tyre. Është për t'u habitur: këta njerëz, që tregohen jashtë goxha fetarë, a nuk kanë i dëgjuar fjalët e të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ue selem: "Më i miri ndër jush është ai që është më i mirë me gruan e vet" [hadithin e ka shënuar Tirmidhiu prej Aishës, radijallahu anha, ndër-sa Albani e ka vlerësuar të saktë].

Janë shumë njerëz, që zbatimin e fesë e kanë përkuftuar vetëm në disa rregulla, duke harruar se feja islame është shumë më e gjerë dhe më gjithëpërfshirëse. Feja islame është një sistem i tërë jetese. I Dërguari i Allahut,

Frytet më cilësore që mund të presim nga një familje që funksionon drejtë janë fëmijët e edukuar mirë, pikërisht ata, që nesër do të bëhen bartësit e kësaj shoqërie.

salAllahu alejhi ue selem, ka pas nëntë gra "nëntë kamera të fshehta", të cilat kanë regjistruar pa ndërprerje tërë sjelljet e tij. Duke përshkruar jetën e tij të përditshme, ato vazhdimisht kanë thënë të njëjtën gjë: "Moral i tij ka qenë Kur'ani". Përfytyroni për një çast sikur t'i pyesnin gratë tona për moralin që shpalosim, për sjelljen tonë,

ibadetin, qëndrimin ndaj familjes. Me siguri që do të dëgjonim diçka, që kurrë s'na kishte shkuar në mendje. Sa herë ka ndodhur të përjetojmë ndonjë fyerje në rrugë apo në shoqëri dhe t'i kemi falur fyesit me të vetmin qëllim, që t'i tregojmë se i përmbahemi fesë tonë, duke treguar durim dhe moral të mirë. Sikur e njëjta fyerje apo edhe diç më pak të vinte nga bashkëshortja, me siguri që nuk do ta falnim edhe aq lehtë. A thua personin që ke takuar rastësisht në rrugë, apo shoku që takon njëherë në muaj meritonjë të falen më lehtë se gruaja jote?! Vallë ai person ka bërë më shumë të mira për ty se gruaja jote, prandaj edhe meriton më tepër?! A kujdeset ai kur ti je i sëmurë, brengoset bashkë me ty kur ke ndonjë hall?! Më së paku që mund të thuhet është se që të dy janë myslimanë dhe duhet t'u falet gabimi dhe të vazhdo-

Përfytyroni për një çast sikur t'i pyesnin gratë tona për moralin që shpalosim, për sjelljen tonë, ibadetin, qëndrimin ndaj familjes. Me siguri që do të dëgjonim diçka, që kurrë s'na kishte shkuar në mendje

het me sjellje të mirë ndaj tyre, por të falurit gabimin bashkëshortes dhe sjellja e mirë ndaj saj s'ka fjalë se është më e merituar. Këtu shihet qartë dallimi mes Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, dhe neve. Para se t'i përmendim metodat më konkrete, duhet të sqarohen disa gjëra me rëndësi, që këto mënyra dhe këshilla të kuptohen drejt. Fakti që këtu po i drejtohem i burrave

dhe kritikojmë sjelljen e tyre ndaj gruas nuk do të thotë se edhe sjellja e grave ndaj burrave nuk meriton kritikë, pas këtij teksti pason shkrimi për të, sepse qëllimi ynë është vendosja e një baraspeshe të sjelljes mes të dy bashkëshortëve. E dyta, shumica e këshillave janë marrë nga jetë-përshkrimi i Pejgamberit, salAllahu alejhi ue selem, e udhëzimi i tij është udhëzimi më i mirë. E treta, as mos mendoni se dikush u garanton më shumë të drejta bashkëshortëve sesa feja islame.

Thirrja e bashkëshortes me emrin më të bukur, më të dashur

Dhe në fund, këshillat që do të përmendim, do të mbeteshin vetëm fjalë të vdekura, të shkruara në letër dhe nuk do të ishin frytdhënëse nëse nuk i marrim që t'i zbatojmë një nga një në jetën e përditshme. Vetëm pas kësaj mund të presim harmoni në martesë, respekt, dashuri dhe besim të ndërsjellë.

Çdo njeri me arsye të shëndoshë e di shumë mirë se si ndikon në shpirtin e tjetrit kur atë e thërret me emrat më të bukur. Të gjithë ne pëlqejmë të na thërrasin me emrat më të bukur, të na respektojnë, të na drejtohen me "zotëri" apo të na thërrasin sipas mbiemrit. E në këtë hulli bashkëshortët nuk përjashtohen kurrsesi; përkundrazi, ata e meritojnë plotësisht që ta thërrasin njëri-tjetrin me emrat më të bukur. Prandaj, nëse burri dëshiron të fitojë dashurinë e gruas së vet, le të provojë këtë mënyrë, le ta thërrasë atë me emrin apo ofiqin që më së shumti i pëlqen asaj. Po të shikojmë jetën e të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, do

të gjejmë se si ai e ka përdorur këtë metodë ndaj grave të veta, ndaj ashabëve; me qëllim për tu fituar zemrat, i thërriste me emrat më të bukur. Në një transmetim të saktë shënohet se Aishen, radijallahu anha, e ka thirrur "Ja Aish" apo: "Ja Humejra". Madje, edhe kur iu është drejtuar jobesimtarëve, të cilët kishin ardhur tek ai me kërkesë për të hequr dorë nga thirrja islame, ai nuk e neglizhonte këtë mënyrë: "A mbarove, o Ebu Velide?", i foli i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, Ukbe b. er-Rabiut. Nga kjo shohim se mënyra e lartpërmendur nuk është ndonjë urtësi e madhe, por të jemi të sigurt se lë gjurmë të madhe te personi me të cilin komunikojmë. Ne

sikur e dimë se sa gjurmë lë emri me të cilin i drejtohem dikujt dhe prandaj e thërrasim po me atë emër apo ofiq, por kjo është problematike kur ky veprim bëhet në kuptimin negativ dhe i thërrasim gratë tona me emra të shëmtuar apo me ofiqin që ajo nuk e pëlqen. Për fat të keq, kemi rastin të dëgjohet disa gra që, sapo janë lidhur në martesë, ankohen: "Posa u martuam, burri im më

thërriste me emra të kafshëve të vogla: mace, sorrë... dhe pas një kohe të kaluar filloi të më thërriste dhe me emra të kafshëve të mëdha..." Si mendon një burrë që gruaja e tij ta dojë pas një sjellje të këtillë?

Dashamirësia dhe hajgarja mes vete

Sa e sa njerëz ka që nuk dinë se ç'është dashamirësia apo hajgarja në jetën e përditshme në raport me gruan e vet. Njerëzit mendojnë se detyrimi i tyre është vetëm sigurimi material i familjes, duke i siguruar vetëm gjërat më të nevojshme për ekzistencë, duke

"Posa u martuam, burri im më thërriste me emra të kafshëve të vogla: mace, sorrë... dhe pas një kohe të kaluar filloi të më thërriste dhe me emra të kafshëve të mëdha..."

harruar kështu anën shpirtërore të martesës. Madje, ndoshta anën më të rëndësishme dhe më të nevojshme për mbajtjen drejt të lundrimit të varkës bashkëshortore. Po të shohim jetën e të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, që në shumëçka dallon nga ajo e jona, do të vërejmë se i ka kushtuar shumë vëmendje dashmirësisë dhe hajgares. Ai, i cili ka qenë kryetar shteti, udhëheqës i ushtrisë, prind, bashkëshort, ka gjetur kohë të ulej me familjen e vet, të bisedonte e të qeshej me ta. Transmetohet prej Aishes, radijallahu anha, se në një rast ka qenë me të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, duke udhëtuar dhe kanë bërë gara, Aisha, radijallahu anha, e ka fituar Pejgamberin. Kur Aisha, radijallahu anha, kishte shtuar në peshë - sikur që tregon ajo për vete - e kishte thirrur Pejgamberi që përsëri të garojnë, por këtë rast fitoi i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, e ai iu kishte drejtuar me fjalët: "Ta ktheva hakun, që më fitove atëherë" (hadithin e shënon Ebu Davudi ndërsa të saktë e ka vlerësuar Albani). Ku jemi ne afër këtij suneti? Sa prej neve kanë gjetur kohë që të bëjnë gara me gruan vet, duke dashur të fitojë dashurinë dhe vëmendjen e saj? Vëlla i nderuar, jepi lirisht pak shpirt sjelljes ndaj gruas tënde. Shtëpia nuk është kazermë ushtarake, ku çdo gjë duhet të jetë në mënyrë të rreptë, serioze dhe nën komandë. Bëj pak hajgare me gruan tënde dhe do të shohësh se kjo sjellje ka për ta rritur dashurinë mes jush dhe do ta përforcojë lidhjen tuaj bashkëshortore.

Shfrytëzimi i metodës "dhuratë befasië"



Është më se e njohur se dhurata apo hedija ndikon në forcimin e lidhjes mes njerëzve, sidomos dhurata e bërë nga bashkëshorti. Dhënia e dhuratës bashkëshortes ka për qëllim që t'i tregohet se nuk është e harruar nga burri i saj, se ai mendon për të, se përpiket t'i plotësojë dëshirat e saj dhe, në këtë formë, ai i tregon kujdesin ndaj saj. Nëse burri i blen diçka që i pëlqen asaj, pa ia kërkuar ajo më parë, inshallah, ky gjest do të ndikojë në fitimin e dashurisë së saj, do të shtojë besimin se burri i saj mendon për të, do të fillojë të mendojë dhe ajo për dëshirat e tij, do të fillojë të tregojë respekt, kujdes, dhe e gjithë kjo do të çojë drejt një forcimi të dashurisë së dyanshme mes bashkëshortëve, që është arritja e synimeve. A nuk ka thënë i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, "Shkëmbeni dhurata mes njëri-tjetrit, që të duheni!"?

Përktheu: R. Kurtishi

Dy Jetimët

Shkruan: Ali TANTAVI

*Tregim kushtuar fëmijëve që kanë mbetur
pa personin më të dashur të tyre "nënë".*

Besniku e vërejtë se nuk është duke marrë vesh asgjë nga ajo që po lexon, sytë e tij janë duke parë shkronja dhe shikuar fjalë, por ai nuk e kupton domethënien e tyre. Ai, në të vërtetë, nuk është duke menduar rreth mësimin. Por është duke menduar rreth asaj gruaje keqbërëse dhe shqetësimin që është duke ia shkaktuar. Si ia zehëroi jetën atij dhe motrës së tij fatkeqe e ua bëri ferr të zjarrtë.

E shikoi orarin dhe pa se nuk i ka mbetur deri te provimi vetëm se edhe një javë. Kurse ai, ka nevojë të lexojë dhe të parapërgatitet. Por..., si të lexojë e të përgatitet? Ku të gjejë qetësi dhe përqendrim në këtë shtëpi, kur kjo grua është duke e ndjekur dhe duke e munduar aq shumë, sa që nuk e le të qetë asnjë moment. Kur ajo, mjaftohet me të, i shkon motrës së tij e cila përjeton mjerime nga ajo. Vallë, a ia dëshiron vetës që të ngel këtë vit shkollor, derisa në vitet e mëparshme ishte më i dalluari nga shokët dhe i pari i klasës.

Duke qenë i thelluar në këto mendime, kur papritmas, dëgjon zërin e gruas si shtrëngatë e erës...! Megjithëse, shtrëngata edhe pse kalon një herë në muaj mbi fusha të mbjella dhe i dëmton duke i thyer ato, më pas pasojnë shirat, toka ujitet, dielli del dhe bima e cila

ishite dëmtuar rikthehet, e së bashku me të dalin edhe bimët tjera. Kurse, shtrëngata e shtëpisë së këtyre dyve çdo moment fryn dhe ua thyen zemrat, atij e motrës së vogël gjashtë vjeçare! Pastaj, kjo thyerje nuk rregullohet më kurrë....! Sikurse furtuna e erës është më e mëshirshme, më e butë, më fisnike e humane se kjo grua. Kjo grua, që të tjerët e shohin të bukur, të ëmbël e që i robëron zemrat...! Por, ajo nuk është vetëm se një gjarpër i cili ecë qetë dhe butë kurse sherrin -helmin e ka të fshehur në gjuhë.

Besniku dëgjonte fyerjet, sharjet dhe zhurmën e dorës së saj...! Iu thaftë dora, e cila është duke ra në fytyrën e fëmijës së pafajshme. Nuk arriti të qëndroj ulur. Por, nuk ka mundësi edhe të shkoj e ta mbroj motrën nga frika e babait. BABAI! Ky njeri i cili bëri besëlidhje me gruan e tij të re dhe i ndihmoi asaj ta luftoj vajzën e mjerë e t'ia zë frymën e jetës, para se ta kuptonte çfarë është jeta. U ngrit të shikojë nga dritarja, e pa motrën të mbështetur për muri të dërmuar, mërëzitur dhe duke qarë. Fytyrën e kishte të zverdhur, rrobat e vjetruara. Kurse afër saj rri gjysmëmotra më e vogël, ku fytyra e saj ishte plotë shëndet, sytë e saj i shkëlqenin dhe ishte e zbukuruar me

rrobe të shtrenjta. E ndjeu se zemra iu hodh te sytë dhe i bëri ato të rrjedhin lot. Vallë, çfarë faji kishte bërë ky fëmijë që të poshtërohet me këto mundime? A nuk ishte ajo gëzimi i babait dhe stolia e jetës së tij? A nuk ishte ajo për babanë personi më i çmuar? Çfarë ka tani ajo që u bë e pavlerë dhe e urreyer. Në këtë shtëpi nuk dëgjon vetëm fyerje dhe qortime ndaj saj. Kurse të gjitha llastimet i takojnë motrës së saj e cila është më e vogël dy vite edhe i tërë përqendrimi është vetëm ndaj saj. Sikurse të ekzistonte vetëm ajo, derisa kjo u bë shërbëtore në shtëpinë e babait të saj.

Madje është edhe më keq, pasi që shërbëtorja ka mundësi të shërbejë në ndonjë shtëpi ku njerëzit kanë zemër, ndjenja dhe janë fetarë, e sillen me të sikur me fëmijën e tyre. Kurse babait të kësaj jetimeje, kjo grua, nuk i ka lënë në gjoks zemër që ta mbronte me denjësi ose të sillej mirë me të. I qenka përcaktuar kësaj jetimeje të mos i ketë të dy prindërit, pasi i vdiq e ëma e ka mbetur pa të dhe i vdiq edhe ndërgjegjja e babait, e mbeti edhe pa baba!

E dëgjoji zërin e njerks duke thirrur:

"Eja këtu oj derre e mjerë!"

"Derre" ishte emri i saj, dhe ajo nuk e thërriste gjatë gjithë kohës vetëm se kështu. E, kur vinte babai i saj në mbrëmje, atëherë e thërriste "vajzë" dhe thoshte: "Eja këtu vajzë, shko andej vajzë"! Kurse gjysmë motra e saj gjithmonë ishte "e dashur", "Ku je e dashur, eja këtu e ëmbla ime"...!

U rikthye zëri në shtëpi duke rënkuar:

"A nuk dëgjon se motra jote është duke qarë? Shko shihe çfarë kërkon dhe sillja...! Pse nuk i përgjigjesh? A je memece? Pyete çfarë dëshiron?"

Ajo e gjora u përgjigj me zë të frikë-

suar:

"Është duke kërkuar çokolatë...!".

"Pse ke mbetur pra duke pritur, shko dhe jepja atë që e kërkon".

Kjo e gjora mbeti duke mos ditur si

Vepra më kriminale që e veproi kjo grua shpirtlig, ishte se ajo ia shëmtoi kësaj vajze emrin më të ëmbël dhe më të përkëdhelur të çdo fëmijë, fjalën që më së pari e mëson ta shqiptojë çdo fëmijë, ajo është "NËNË".

t'ia sqarojë se pjesa e mbetur e çokollatës është e saj. Babai i saj kishte blerë dje një çokolatë e ia kishte dhënë motrës së vogël, ajo filloi ta ngrejë derisa kjo e shikonte. Motra e vogël, u bezdis nga shikimet e saja dhe e ndau një pjesë e ia hodhi asaj, ashtu si ia hedh njeriu kafshatën maces e cila i shkrepitin sytë nga ushqimi. Ajo, e shkreta e mori atë pjesë me gëzim. Nuk munda

ta ngrejë edhe pse e kishte endje, por e fshehu. Orë e çast shkonte te vendi ku e kishte fshehur dhe e shikonte. Nga ëndja, e kafshoi një herë. Kurse motra e saj e llastuar e vërejti këtë dhe tani është duke ia kërkuar çokollatën.

"Ku ku për ty, oj e mallkuar, ku është çokollata?"

Ajo heshti... por motra e vogël tha:

"E ka lënë atje oj nënë, kjo e mallkuara e mori nga unë!"


E mori gruaja vajzën e saj dhe vajzën e burrit e i dërgoi te vendi ku e fshihte pjesën e çokollatës, ashtu si dërgohet i akuzuari të merret në pyetje. Kur u "vërtetua" se ka bërë "krim" dhe kur njerka e pa "dëshminë" (çokollatën), filloi sprova e madhe për vajzën.

"Oj vjedhacake e mjerë! A kështu të ka mësuar nëna jote... të vjedhësh atë që nuk është e jotja!"

Besniku ishte në gjendje t'i përballonte të gjitha, përveçse t'i ofendohet e ëma. Kur e dëgjoji se ajo e përmendi atë, nuk arriti ta përmbaj veten dhe thërriti:

"Unë, assesi nuk lejoj që ti të flasësh keq për nënën time!"

Njerka iu përvesh atij dhe iu vërsul...



Gjithmonë ajo e poshtëronte nënën e tyre dhe qëllimisht e lëndonte, kurse ai duronte duke heshtur dhe nuk shfaqte vëmendje dhe përfillje. E kjo e tërbonte edhe më shumë gruan. Prandaj e kishte ëndje dhe mezi priste të gjente rrugë për ta shfryer (shëruar) tërbimin, kurse tani i paska ardhur rasti ta bëjë këtë:

- "Nuk më lejon ti mua...? I lutem zotërisë suaj më lejoni...! Unë jam nën nderin e juaj...oh! A nuk mjafton se unë lodhem e rraskapitem për të të ofruar

ushqim dhe i bëj të gjitha shërbimet tjera ndaj teje. Kurse ti nuk vlen për asgjë, vetëm se të shkruash në fletoren tënde. I tërë munda pas teje më paska humbur, o i njollosur... Por, nuk është për tu çuditur pasi ti je i biri i nënës tënde!".

- "Të thash mos e përmend nënën time përndryshe unë do të bëj që të heshtësh!".

E liga, qëllimisht iu afrua djalit katërmëdhjetë vjeçar dhe filloi të bërtas që të dëgjojnë fqinjët:

- "Do që të më rrahësh? O besëthyes, o mohues i mirësive...o njerëz! Më ndihmoni...!".

Fqinjët nga zhurma që dëgjuan u grumbulluan, kurse Besniku u përvodh në dhomën e tij, në skutën që e quajtën dhomë, të cilën ia përcaktuan atij dhe të motrës për t'u çliruar zonja e shtëpisë dhe mos t'i ketë gjithmonë këta fëmijë të bezdisur para fytyrës!

Në mbrëmje u kthye babai, i mërrolur, zakonisht rrinte ashtu, i ngrysur, nuk qeshte para fëmijëve. Këtë e bënte ai me qëllim, që ata të kenë frikë dhe mos të sillen pahijshëm e të fitojnë moral të keq! Ai, më herët nuk ishte kështu, por ia vuri vetës këtë traditë, prej asaj dite që u paraqitë në shtëpi kjo shtriga dhe ia hodhi helmin në trup. Ajo, ia ka ngulitur atij në mendje se Besniku dhe motra e tij janë dy fëmijë të llastuar (halitur) dhe të neveritshëm nuk bënë punë tjetër gjë me ta vetëm se ashpërsia dhe ngurtësia...

Kjo e liga, kur afrohej koha e kthimit të babait, i hiqte rrobat e saja të vjetra dhe vishej me rrobe të bukura, ashtu si e largonte nga vetja fytyrën e vrazhdë djallëzore duke e zëvendësuar me një fytyrë që ka shenja të dëlirësisë e të pafajësisë. Gjithashtu, nuk harronte t'i pastronte edhe dy vajzat e tu veshte atyre rrobe të njëjta që mos të kuptojë

babai se ajo po preferon vajzën e saj ndaj jetimes...

Kur hyri babai, ajo e takoi me pritje të mirë, të përzemërt dhe emocionuese, por, fytyrës i dha ngjyrë të dhimbjes që të kuptohet se i është bërë zullum gjatë ditës. E përcolli atë në dhomën e fjetjes duke i ndihmuar ta heq pallton dhe atje i tregoi ndodhinë e përgënjeshtuar të ditës duke e deformuar atë, kështu ia mbushi gjoksin me hidhërim dhe tërbim ndaj fëmijëve te tij.

Ai doli nga dhoma duke mos parë para vetës nga hidhërimi, e thirri vajzën e cila erdhi e frikësuar ashtu si shkohet për vdekje. Ajo u ndal para tij si do të shtangej një qengj i dobët para ujkut. Kurse ai, u ulë në një karrige të lartë sikur të jetë karrige e gjyqit. Filloi t'i bërtas e ta qortoj ashpër duke ia sqaruar shëmtinë e vjedhjes. Gjatë kësaj kohe, e shikonte Besnikun me sy të shtrembër. Këto shikime i paralajmëronin atij të keqen. Ai nuk kishte çfarë të bënte kur dëgjonte se si akuzohej motra e pafajshme për vjedhje por vetëm heshtte. Iu afrua babait me qëllim t'ia sqaroj çështjen dhe me këtë ai vetëm se ia përshpejtoi vetës të keqen.

Zëri i babait të zemëruar dhe shqetësuar eksplodoi si vullkan mbi djalin e vogël dhe filloi të dridhet shtëpia:

"O i pacipë, dëshiron ta rrahësh njerikën tënde, edebsuz i mallkuar? Kam menduar se kur t'i arrish të katërmbëdhjetat do të bëhesh burrë! A e rrah njeriu njerikën e tij? Do ta thyej dorën, ore fatkeq!"

Besniku tentoi të bëj ndonjë sqarim:

"Vallahi o baba nuk është e vërtet...!"

"Prapë paturpësi! A nuk të ka mbetur asnjë moral? Edhe e përgënjeshtroi njerikën tënde?"

"Unë nuk e përgënjeshtroj. Por them se ajo thotë fjalë të pavërteta".

Në këtë moment u ngrit babai i hum-

bur në hidhërimet me të cilat ishte mbushur nga dredhitë e kësaj gruaje. Iu vërsul djalit dhe filloi ta rrah sikur ta kishte humbur vetëdijen. Nuk u mjaftua vetëm me kaq, por ia mori fletoren e zezë në të cilën Besniku kishte shkruar të gjitha mësimet dhe e grisi... pastaj e la atë dhe motrën pa darkë si dënim dhe tërheqje vërejtjeje ndaj tyre.

Çifti me vajzën e tyre hëngrën darkë dhe shkuan në gjumë. Djaloşi ishte i shtrirë duke shikuar fletoren e grisur për të cilën kishte kaluar net të tëra duke e shkruar. Nuk i hahej dhe nuk i flihej nga mërzia. Fletoren për të cilën i ka qorruar sytë duke e shkruar. Nëpërmjet të cilës e ndërtonte ardhmërinë. U ngrit dhe filloi t'i mbledh pjesët e grisura, ashtu sikur nëna do t'i mblidhte pjesët e trupit të fëmijës që i është ekspozuar ndonjë bombe... Por, jo, janë me mija pjesë, nuk ka mundësi të bashkohen. Nuk është e mundur të kthehet ajo në fletore që të lexohej, ashtu si nuk do të mund të ktheheshin pjesët e fëmijës në një trup që flet e lëvizë. Ai u bind se ka rënë nga provimi dhe se e humbi vitin. Iu bë shumë e paduruar kjo dhe nuk arrinte dot ta qetësojë vetën nga këto padrejtësi. E ndjeu se bota po i sillet dhe filloi ta kthejë kujtimin e ditëve të kaluara ashtu si do të kthehej një film prapa...

Përnjëherë iu kujtua fytyra e ëmbël e nënës dhe buzëqeshja e saj, e cila ia harronte të gjitha dhimbjet. Gjoksin e saj, e kishte vend ku gjente qetësinë gjatë fatkeqësive të jetës. Iu kujtua ajo kur ishte në moshën më të re dhe të shëndetshme. Iu kujtua shtëpia, kur ishte e qetë, e pastër dhe plotë dashuri. Iu kujtua babai kur ishte baba i vërtet që derdhte shpirtin prindëror nga dy sytë e mallëngjyer, duart e tij përplot me butësi dhe bamirësi, gjuhën gjithmonë të lagur me fjalë të mira dhe të dashura.

E riktheu kujtimin atëherë kur nënën e kishte të sëmurë, por ai nuk merakosej, duke paramenduar se është një sëmundje e rastësishme dhe kalimtare... Pas një kohe, ai vëren në shtëpi rrëmuje, shihte shqetësimin në fytyrat e familjarëve, i dëgjonte ata duke qarë dhe si e largonin nënën të shtrirë në një dërrasë nga shtëpia duke e fshehur lajmin nga ai. Por, ai kuptoi se nëna e tij kishte VDEKUR! E vdekur...! Fjalë që e dëgjonte dhe e kalonte duke mos ia vënë veshin domethënies. Ai, kishte dëgjuar për vdekjen dhe kishte lexuar diçka në libra, por nuk e kishte parë për së afërmi dhe ajo, ende nuk kishte vizituar shtëpinë e tij. Nuk e kishte shijuar kuptimin e saj tek asnjë i dashur dhe i afërm i tij. Por, ditët atij shumë shpejtë ia mësuan kuptimin e vdekjes. Ajo ndodhi pasi i vdiq e ëma, në mëngjesin e ditës së nesërme, kur atë e zgjoi vaji i motrës e cila ishte shumë e dashur për nënën e saj. Motra, gjithashtu, ishte e dashur edhe për babanë atyre ditëve. Ajo, atë mëngjes, i hapi sytë dhe nuk gjeti nënën pranë saj t'i jap gjë dhe ta përqafojë, prandaj u shtua vaji i saj. Kurse Besniku filloi ta thërras: NËNË...u shqetësua dhe filloi ta kërkoj. E gjeti babanë dhe disa nga të afërmit duke qarë, gjithashtu... i pyeti se ku e ka nënën? Nuk iu përgjigjën... Ai kur u nis për të shkuar në shkollë, thirri prapë, që të vijë e ëma dhe t'ia përgatis çantën, ta vesh dhe ta përcjell te dera duke e puthur dhe këshilluar që të mos zihet me askënd e mos të luaj në rrugë të asfaltuar. Kurse kur u largua pakëz nga shtëpia, e ktheu kokën se mos po e sheh të ëmën, pasi ai kur arrinte në atë vend ajo e përsëriste lamtumirën dhe porosinë, por nuk e pa! U kthye nga shkolla, por në vend të nënës e gjeti një grua të huaj duke i dhënë gjë motrës... pse ajo gruaja e huaj i jepka gjë motrës.. ku është nëna...?

E kthen kujtesën mbrapa dhe e sheh

babanë, atyre ditëve kur vdiq e ëma, ai ishte i butë dhe miqësor ndaj tij dhe motrës, mundahej t'u bëhet atyre nënë dhe baba. Por ky baba ndryshoi nga ajo ditë ogurzi. Ditën kur i tha: "Besnik, babai do të sjell nënë të re në shtëpi...!". Nënë të re? Këtë nuk e kishte dëgjuar më parë. Ai dinte se si sillet motra e re; nëna e lind nga barku i saj. Kurse nënë tjetër të re, nga lind kjo? Ai priti derisa i erdhi nëna e re. Në fillim ajo ishte e ëmbël, rroba të bukura, faqet i kishte ngjyrë muzgu, buzët të kuqe, jo sikur buzët e njerëzve tjerë. U çudit nga kjo ngjyrë e buzëve. Por, nuk e deshi dhe nuk anoi kah ajo, asnjëherë. Ditëve të para ajo ishte e butë dhe e dashur sikur një fidan i imë. Por, kur kaluan ditët, kur ajo u vendos e u stabilizua dhe i forcoi rrënjët, u bë e thatë si trungu i pemës së madhe që i tradhton ata që e shohin me fletat dhe lulëzimin e jashtëm. Kur e lindi vajzën u bë një dreqe, gjarpër i fshehur që mbulohet me lëkurën e një gruaje të bukur. Allahu na mbrojti nga gruaja e bukur që në realitet është një shejtane në formë të gjarpri të fshehur.

U fshinë të gjitha fotografitë e së kaluarës së dashur dhe u zhduk filmi. Nuk mbeti nga tërë ajo që e kujtonte vetëm se kjo foto e shëmtuar dhe e neveritshme e kësaj gruaje. Iu zmadhua aq shumë derisa e përfshiu tërë jetën dhe iu mbush e tëra me këtë, që ta pengoj depërtimin e dritës së shpresës...

E dëgjoi zërin e saj duke qeshur dhe iu duk si të reshurat e mitralozit që e goditën zemrën e tij. Qeshja e kësaj gruaje që ka marrë vendin e nënës përzihej me vringëllima të qeshurave të babait të tij...

Ashtu i heshtur dëgjoi edhe një zë vaji të zbehur, të mërziur dhe të vazhdueshëm. I ra ndërmend motra të cilën e kishte harruar gjatë çasteve të kujtim-it. Nga uria që e përjetonte ai, ia kujtoi

se edhe e motra e mjerë kishte mbetur pa darkë. E ndoshta edhe nuk ka drekuar fare, pasi kjo e liga tërë ditën nuk e lë të qetë duke e shtyrë t'i shërbejë asaj dhe vajzës së saj. Ajo e mbanë të mbyllur kuzhinën, duke mos i dhënë asaj vetëm se një copë buke të thatë. Kurse vajzën e saj e ushqen fshehurazi. Kur vjen babai, ajo në mbrëmje para tij e vesh fytyrën me dëlirësi dhe i ankohet se si kjo vajzë është e sëmurë dhe e dobët.

- "E gjorë kjo vajzë, nuk han fare... shikojë trupin e saj. Pse nuk po e dërgon te mjeku? Por çfarë t'i bëj mjeku kur ajo është kokëforte dhe e pasjellshme... "thotë ajo. "Unë e thirri të hajë por ajo nuk më përgjigjet... kryeneçësia e saj do ta shkatërrojë!"

Kurse babai i saj duke u besuar këtyre fjalëve e thërret dhe i thotë:

- "Çfarë ke kështu që mbanë inat? Ha, se do të të rrah".

Ajo e gjora, afrohet për të ngrënë. Por kur e sheh gruan e cila e shikon mbrapa babait me sy të kërcënimit dhe e vëren se ajo fytyrë është shndërruar në fytyrë të hienës, frikohet dhe fillon të dridhet...

Gruaja i thotë burrit të saj:

- "A të kam thënë se është shumë kryeneçe dhe ka nevojë të edukohet?"

Babai e lëviz kokën dhe fillon ta edukojë duke e goditur në fytyrë, ngrehur veshin ose edhe duke e nxjerr nga kuzhina dhe kështu darka e saj përfundon me kaq!

Besnikut iu kujtua motra dhe shkoi tek ajo, e ngriti dhe e përqafoi.

- "Çfarë ke? Pse qan? Heshtë zemra ime!". E përqafoi dhe e përkëdhel.

- "A je e uritur!"

A je e uritur? Por, prej nga t'i sjell ushqim? U ngrit të kërktojë... Për fatin e tij e gjeti derën e kuzhinës hapur, pasi që zakonisht rri mbyllur. Në tavolinë gjeti të mbeturat e ushqimit. Ia solli

motrës, ajo u gëzua dhe hëngri. Besniku ndjeu dhimbje nga gëzimi i motrës së saj që u ngop me të mbeturat e ushqimit dhe prapë iu kthyen në kujtesë fotografitë e të kaluarës dhe iu paraqitë nëna në mendime.

E mori në gjoks motrën dhe e përqafoi duke e shtrënguar dhe duke i dhënë ngrohtësi për të cilën nuk kishte mundësi ta ngopte. E gjora, në brendësi kishte zbrazësi të përkëdheljes prindërore që nuk kishte mundësi t'ia jepte vëllai, pasi edhe atij i mungonte e njëjta.

E mori dhe e vendosi në shtrat duke e puthur ashtu dhe përkëdhelur. Filloi t'i tregojë diç për të cilën edhe ai vetë kishte nevojë të dëgjonte. Rreth nënës, të cilën mezi e kujtonte edhe vete Besniku pasi kishin kaluar ca vite nga ndarja.

Kur e përmendte Besniku atë duke thirrur "nënë", motra ndiente shqetësim dhe frikë, pasi nuk kuptonte për kë po fletë vëllai i saj. Motra e saj e njihnte vetëm një grua që e thërriste me emrin "nënë", ajo ishte kjo grua e lig që ia mbushi jetën plotë ankth.

Ndoshta vepra më kriminale që e veproi kjo grua shpirtlig, ishte se ajo ia shëmtoi kësaj vajze emrin më të ëmbël dhe më të përkëdhelur të çdo fëmije, fjalën që më së pari e mëson ta shqiptojë çdo fëmijë, ajo është "NËNË".

Pas një kohe ata futen në një gjumë të thellë, pasi që kishin përfunduar edhe një ditë të zakonshme për ta. Vallë kur do të përjetojnë ata ndonjë ditë të pazakonshme. Ndoshta ëndrra do të jetë rast për ta, të përjetojnë diç të mirë, që nuk kanë mundësi ta përjetojnë në realitet. (fund)

*Përktheu dhe përshtati:
Alaudin ABAZI*

Mes Mehmed Fatihit dhe Spiderman-it

Shkruan: Halid ABDULATIF

Në vend të hyrjes:

Thirrje drejtuar çdo kreu të shtëpisë... uluni me fëmijët tuaj dhe shihni pasqyrën e punës tuaj. Sa jeni të kënaqur me sjelljen e tyre dhe me mënyrën si ata i kuptojnë gjërat. A mund të themi vallë me plot bindje se fëmijët tanë i kanë të qarta gjërat. Sa drejtë e kuptojnë termin trimëri dhe heroizëm. Në këtë kohë të "heronjve" të rrejshëm jemi të obliguar që t'ia sqarojmë sa më mirë fëmijës kuptimin e fjalës hero.

Heronjtë në jetën e fëmijëve:

Heroizmi dhe fëmijët, nga t'ia mba-jmë?!

Kush janë heronjtë në jetën e fëmijëve?!

Si e kuptojnë fëmijët heroizmin?!

Si ndikon në ardhmërinë e fëmijëve konceptimi i heroizmit?!

Janë pyetje të rëndësishme, për të cilat i lus prindërit që përgjigjen t'ia japin vetvetes në çastin e së vërtetës. Kam shpesë se përgjigjet e këtyre pyetjeve do të pajtohen me realitetin dhe nuk do të mbeten pjesë e imagji-

natës apo shpresave. Le të jetë çasti i përgjigjes moment i sinqeritetit dhe transparencës, aq sa është i saktë reflektimi i objektit në pasqyre...

Dëshiroj të bëhem Spiderman!?

Kur një mësuese, në një foshnjore islame, ku i jepet rëndësi edukatës në vlera islame e pyeti fëmijën, që vinte nga një familje të njohur si familje që i respekton parimet Islame, se çfarë dëshiron të bëhet në ardhmëri ai tha: dëshiroj të bëhem Spiderman.

Rasti në fjalë është i vërtetë dhe të njëjtin ia ka transmetuar nënës së fëmijës, e cila ka marrë prej mësueses një letër, ku kjo e këshillonte që t'i shpjegonte sa më qartë se cila duhet të jetë shëmbëlltyra e tij në jetë.

Kushteve të mira që i ofrohen fëmijës duhet t'u shtohen edhe të qenit i informuar për gjendjen e fëmijës dhe mbikëqyrja e vazhdueshme, faktorë këto, që me lejen e Allahut, sigurojnë që fëmija të mbetet i sigurt nga pasojat e luftës ideologjike, e cila, falë larushisë së mjeteve të informimit që i përhapin, na



paraqitet në forma të ndryshme.

El Faruku është djali im i madh!

Kur në shpirtin e fëmijës jepet saktë nocioni i shëmbëlltyrës, vijon hapi që nënkupton nënvijëzimin e dallimeve të shumta mes heronjve shëmbëlltyrë nga historia e ummetit dhe "heronjve" të rrejtshëm "të fuqishëm fizikisht dhe me mjete teknike", të paraqitur në shumë tregime dhe filma të animuar.

Është e nevojshme të fuqizohet koncepti i motivimit fetar, qëllimit të sigurtë dhe synimit fisnik për të cilin vepronjë heronjtë tanë!

Këto dallime, si dhe tjerat, u mundëson të rinjve të rriten me pasqyrim të qartë për trimërinë, që nuk korrespondon me kuptimin



e saj "trendist" si trup i zhvilluar, lëvizje imagjinare, hungërim dhe britma. Fëmija mysliman e di qartë kuptimin e trimërisë, fuqisë dhe xhihadit dhe nuk mashtrohet me "heronjtë" e globalizimit dhe ligjit të xhuglës.

Shkronja në fund...

Nëse dëshiron ta mësosh se sa efikas ke qenë në edukimin e fëmijës dhe sa ke kontribuar që ata qartë ta kuptojnë termin heroizëm pyeti le të bëjnë krahasimin mes Omer El Farukut dhe Spidermanit ose mes Salahunit dhe Supermenit.

Allahu është Dhurues i suksesit dhe i luturi për ndihmë në çdo situatë.

*Përktheu dhe përshtati:
Talha KURTISHI*

Kujto...



Për ku je nis oj motra ime dashur..
 Ulu dhe medito rreth qenies tënde
 Mos vallë, të solli ndonjë valë e detit
 Apo, rastësisht në mesin e njerëzve ndodhe
 Nga erdhe, dhe ku po shkon,
 Të lutem, më dëgjo, dhe mos më thuaj, mjaft!
 A e din se, ka kohë te gjatë, që për ty mendoj
 Për ty lutem, çdoherë që kokën në sexhde vendoj
 Mos motra ime, trupin tënd gjithkujt mos ia zbulo
 Se bukurinë e ke dhunti prej Zotit, mos e nënçmo
 Kujtoi dhe dhuntitë tjera, dhe mendjen e shëndoshë
 Thuaj o Zot i gjithësisë, veç ty të falënderoj
 Pendimi për ty, asnjëherë nuk është vonë.

E di që ndjehesh fajtores për atë që po bën
 Po djalli i mallkuar, veprat po t'i zbukuron
 Ruaje veten tënde vetëm për një person
 Se të humbet vlera, mbetesh për askënd
 Bëhu e fort, e largohu nga ai zakon
 se me vepra të tilla asgjë nuk fiton
 përveç zjarrit te xhehenemit, që dhimbshëm dënon.

Mos i mbyll sytë para realitetit
 e më pas të thuash paskam vepruar si të verbëtit
 Le të jetë për ty nesër një ditë, e botës së re
 duke i thënë lamtumirë jetës pa fe
 ke për t'i sjell vetes lumturi
 kënaqësia e të cilës nuk ka kufi
 pendohu sa më shpejt, se vdekja nuk garanton
 ajo nuk ka mëshirë, dhe hallin nuk ta qan

Në momentin e vdekjes për ndihmë kë do ta kërkosh?!
 Allahun e madhëruar apo ata që të shfrytëzuan?!
 Fjalë arsye nuk të mbeten të më thuash
 zgjatma dorën dhe eja me mua
 drejt rrugës së Zotit tënd, që të gjithëve na ka krijuar
 edhe zbukuruar...

Umu HAMZA

D&K STUDIO



Mbajtja dhe shitblerja e qenve

Shkruan: Bekir HALIMI

Dje, duke ndenjur në zyrë, më erdhi një vëlla besimtar dhe më pyeti për shitjen e qenve. Ai e dinte se mbajtja e qenve është e ndaluar, mirëpo nuk kishte dijeni edhe rreth faktit se është e ndaluar edhe shitja e tyre, andaj e hulumtova këtë çështje në disa libra të fikhut dhe në internet dhe nga ky hulumtim i gjeta këto informata dhe ua paraqes si fetva.

Një: Mbajtja e qenve.

Nga pikëpamja e fesë ndalohet kategorikisht mbajtja e qenve përpos se në tri raste:

- a) për sigurim të pasurisë në shtëpi;
- b) qen për sigurim të bagëtisë;
- c) qen për gjueti, apo zagari që i themi ne.

Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ai që mban qen, për çdo ditë i pakësohen shpërblimet e veprave të tija për një kirat, përpos qenit të bujqësisë apo për të ruajtur bagëtinë". (Buhariu, nr. 2145).

Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë: "Ai që posedon qen, i cili nuk është qen gjuetie, bagëtie apo toke, i pakësohet nga shpërblimi dy kirate për çdo ditë". (Muslimi, nr. 2974 dhe 2943).

Transmeton Ibn Maxheja nga Ali b. Ebi Talibi, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë: "Melaqet nuk hyjnë në shtëpinë ku ka qen apo fotografi". (Ibën Maxheja, nr. 3640. Albani thotë se hadithi është sahih).

Këto hadithe na tregojnë se posedimi i qenit është i ndaluar përpos kategorive që janë përjashtuar, e ato janë: qeni për bagëtinë, qeni për gjuetinë dhe qeni për bujqësinë (Për ruajtjen e pasurisë).

Ibën Abdul-Beri, rahimehull-llah, thotë: "Ky hadith na tregon se lejohet të mbahen qen për gjueti, për bagëtinë dhe për bujqësinë".

Në hadithet e lartpërmendura janë përmendur dy pakësime të shpërblimeve. Në njërin një kirat e në të dytin dy kirate, si të bëhet bashkimi mes këtyre dy çështjeve.

Dijetarët si përgjigje të kësaj dileme kanë thënë:

- I pakësohen shpërblimet për dy kirate atij që ka qenë që bën shumë dëm, kurse për një atij që bën dëm më pak.

- Në fillim Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, tregoi se i pakësohet një kirat, kurse më vonë e shtoi këtë dënim që të jetë dy kirate, për të shtyrë edhe më shumë të largohen njerëzit nga mbajtja e qenve.

Shih: "Sherhu Sahihi Muslim", 10/342

dhe "Fet'hul-Bari", 5/9.

Shejh Ibën Uthejmini, rahimehull-llah, në komentin e librit "Rijadus-Salihin", 4/241, thotë: "Mbajtja dhe posedimi i qenve është haram, madje prej mëkateve të mëdha, sepse ai që mban qen, përpos asaj që përjashtohet, për çdo ditë i pakësohet shpërblimi për dy kirate..."

Nga urtësia e Allahut është fakti: të fëlliqurit janë për të fëlliqurit, dhe në këtë drejtim është edhe informata se jobesimtarët, çifutët, të krishterët dhe komunistët në lindje dhe në perëndim, secili prej tyre mban nga një qen. Ai për çdo ditë e lan me sapun dhe lënde tjera për pastrim! Edhe pse po ta lante me ujin e detit dhe sapunin e botës ai nuk do të pastrohej! Sepse papastërtia e qenit është subjektive, kurse papastërtia subjektive nuk pastrohet ndryshe përpos se me shkatërrim apo eliminim të tij të përgjithshëm.

Kjo është nga Urtësia e Allahut. Të rakordohen ata të fëlliqurit me atë që është e fëlliqur. Ashtu sikurse ata rakordohen dhe adaptohen me vahjin (inspirimin dhe motivimin) e shejtanit, sepse edhe vet kufri dhe mosbesimi i tyre është nga shpallja e shejtanit dhe punë e shejtanit. Shejtani urdhëron në imoralitet dhe vepra të këqija, urdhëron në kufër dhe devijim. Kurse ata që u nënshtrohen janë robër të shejtanit dhe të epsheve të tyre. E lusim Allahun të na udhëzojë neve dhe ata".

Dy: Shitja e qenve.

Shitja e qenve sipas argumenteve fetare është kategorikisht e ndaluar edhe nëse qeni është nga lloji dhe kategoria që lejohet të mbahet duke u mbështetur në shumë hadithe që ndalojnë shitjen e qenve dhe përderisa janë hadithe që në mënyrë të përgjithshme e ndalojnë shitjen e qenve i kaplon edhe ata që lejohet të mbahen.

Transmeton Buhariu nga Ebu Xhuhejfe, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen se: "Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka ndaluar çmimin (fitimin) e qenit". (Buhariu nr. 1944).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Mesudi, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen se: "Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka ndaluar çmimin (fitimin) e qenit, dhuratën e prostitutës dhe ëmbëlsirat e falxhorit". (Buhariu nr. 2083 dhe Muslimi nr. 2930).

Transmeton Ebu Davudi nga Abdullah b. Abasi, radijAllahu anhu, i cili na rrëfen: "Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka ndaluar çmimin e qenit e nëse vjen dikush të kërkon çmimin e qenit mbushjani duart me dhe". (Ebu Davudi, nr. 3021. Hafidh Ibën Haxheri, rahimehull-llah, ka thënë: senedi është sahih, gjithashtu edhe shejh Albani, rahimehull-llah, e ka konsideruar të vërtetë këtë hadith).



Imam Neveviu, rahimehull-llah, duke komentuar këtë hadith në librin e tij "Komenti i Sahihut të Muslimit" mes tjerash thotë: "Ndalimi i çmimit të qenit, fakti se është fitimi më i keq dhe së është para e fëlliqur tregojnë se ndalohet shitja e tij dhe se fetarisht nuk është kontratë e saktë kontrata për shitje të tij, nuk lejohet të merret çmimi për te e as vlera nga ai që e shkatërron, pa marr parasysh se a është zagat ose jo, a bën të mbahet ose jo. Ky është mendimi i xhumhurit - shumicës të dijetarëve. Prej tyre janë: Ebu Hurejre, Hasan Basriu, Rebia, Evzaiu, Hakemi, Hammadi, Shafiu, Ahmedi, Davudi, Ibën Mundhiri, etj. Ebu Hanifeja, rahimehullah, ka thënë: është e saktë kontrata e shitjes së qenve nga të cilët ka dobi dhe nëse i shkatërron dikush duhet paguar vlerën... Mirëpo argumenti i shumicës së dijetarëve janë këto hadithe".

Hafidh b. Haxheri, rahimehullah, thotë: "Nga këto ndalesa kuptohet se shitja e qenit është haram dhe është i përgjithshëm për çdo qen, qoftë i stërvitur apo jo, bën të mbahet ose jo. Nga kjo lind edhe çështja tjetër se nuk duhet kompensuar nëse dikush ia shkatërron qenin dikujt. Kështu kanë thënë xhumhuri - shumica e dijetarëve".

Këshilli i përhershëm për fetva ka thënë:

"Nuk lejohet shitja e qenit e as marrja e fitimit nga kjo shitje, qoftë ai qen, qen roje apo gahu, për shkak të hadithit që e transmeton Ebu Mesudi, Ukbe ibën Amër, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka ndaluar çmimin (fitimin) e qenit, dhuratën e prostitutës dhe ëmbëlsirat e fallxhorit". (Buhariu nr. 2083 dhe Muslimi nr. 2930)". (Shiko: "Fetvatë e këshillit të përhershëm për fetva", 13/36).

Shejh Ibën Bazi, rahimehull-llah, thotë: "Shitja e qenit është shitblerje jovalide, e

kotë". (Shiko: "Mexhmuu Fetava Ibën Baz", 19/39).

Shejh Ibën Utthejmini, rahimehull-llah, në librin "Sherhul-Mumti", 8/90 ka thënë: "Nuk lejohet shitja e qenit edhe në qoftë se e shet për gjueti, edhe kjo nuk lejohet".

"Ai që mban qen, për çdo ditë i pakësohen shpërblimet e veprave të tija për një kirat, përpos qenit të bujqësisë apo për të ruajtur bagëtinë".

Dikush është mbështetur në disa hadithe për të bërë përjashtim qenin për gjah, zagarin, mirëpo të gjitha ato hadithe janë të dobëta.

Imam Neveviu, rahimehull-llah, në librin "Komenti i Sahihut të Muslimit" thotë: "Hadithet që përjashtojnë qenin për gjah, zagarin dhe për kompensimin e tij, të gjitha këto janë të dobëta me pajtimin e imamëve të hadithit".

Tre: Blerja e qenit për nevojë.

Nëse një njeri ka nevojë për qen gahu, zagat apo për të siguruar shtëpinë a bagëtinë dhe askush nuk i jep asi qeni, i lejohet të blejë, kurse mëkatën e ka ai që e shet, sepse shet një gjë që nuk i lejohet ta shesë, e jo ky që e blen.

Ibën Hazmi, rahimehull-llah, në librin e tij "El-Muhal-la", 7/493 thotë: "Nuk lejohet shitja e qenit, as i atij për gjah e as i atij për bagëti, mirëpo nëse ka nevojë të madhe për qen dhe nuk gjen kush i jep, atëherë i takon ta blejë. Pra, i lejohet myshterisë (blerësit) dhe i ndalohet shitësit... kjo i ngjan ryshfetit që jepet për të larguar zullumin, apo për të çliruar robin, apo për t'ia bërë qejfin zullumqarit (që mos të bën zullum)".

Kjo është e tëra që arrita të grumbulloj në këtë rast, por çdo herë Allahu e di më së miri.

(në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com)

Përshkrimi i momenteve të Ahiretit

Shkruan: Agim BEKIRI

Besimi në Ditën e Ahiretit përfshin aspektin e përgjithshëm dhe një detaj të vetë besimit. Besim i përgjithshëm do të thotë: të besuarit se ekziston një ditë në të cilën Allahu, subhanehu ve teala, do t'i mbledhë të parit dhe të fundit dhe çdonjërin do ta shpërblejë sipas veprës së tij, disa do të jenë për në xhenet e disa të tjerë për në Zjarr. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Thuaj: "Edhe të parit edhe të fundit!" Keni për t'u tubuar në një ditë të caktuar!"

Sa i takon detajit të besimit në Ditën e Ahiretit, ai nënkupton besimin në çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes dhe në mënyrë të hollësishme. Këtu përfshihet:

Një: sprova e varrit: bëhet fjalë për pyetjet që do t'i bëhen të vdekurit në varr, për Zotin, pejgamberin dhe fenë e tij. Në këtë moment Allahu i përqendron me fjalën e palëkundshme ata të cilët kanë besuar, siç është përmendur në hadith se kur të pyetet, ai (besimtari) do të thotë: Zoti im është Allahu, feja ime Islami dhe pejgamberi im

Muhamedi. Pra, obligohemi të besojmë në mënyrë të hollësishme këtë që përshkruhet në hadithe, si do të përgjigjet besimtari, si do të përgjigjet munafiku e kështu me radhë.

Dy: dënimi dhe shpërblimi në varr: Obligohemi të besojmë në dënimin dhe shpërblimin e varrit dhe se ai, ose do të jetë një gropë prej gropave të Zjarrit, ose një kopsht prej kopshteve të xhenetit. Varrri është hapi i parë i Ahiretit, kush shpëton prej tij, do ta ketë më lehtë më pas. Ai që nuk shpëton prej tij, më pas do ta ketë më vështirë. Në fakt për të ka filluar Kiameti.

Edhe trupi, sikundër shpirti, do ta përjetojnë dënimin apo shpërblimin në varr. Ndonjëherë, ky përjetim mund të jetë i veçantë për shpirtin. Dënimi do të jetë për të padrejtët, ndërsa shpërblimi për besimtarët e vërtetë.

Jeta e varrit quhet Berzah. Në atë jetë, i vdekuri ja do të dënohet ja do të shpërblehet, pa marrë parasysh nëse varrosët apo jo (nëse është djegur, fundosur në ujë, apo e kanë ngrënë bishat, ai patjetër që do të përjetojë dënimin apo shpërblimin). Allahu, subhanehu

ve tealë, thotë: "Ata i nënshtrohen Zjarrit në mëngjes dhe në mbrëmje, e ditën e kiametit (u thuhet engjëjve): "Ithtarët e faraonit futini në dënimin më të rëndë!"

Tre: fryrja në Sur: suri është një bori që do t'i fryjë Israfili, alejhi selam. Kur t'i fryjë të parën herë, do të vdesin të gjitha krijesat, me përjashtim të atyre që Allahu dëshiron të mos vdesin. Kur t'i fryjë të dytën herë, do të ringjallen të gjitha krijesat që jetuan që nga koha kur Allahu krijoi dynjanë e deri në kiamet. Allahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Dhe i fryhet Surit dhe bie i vdekur çka ka në qiej dhe çka ka në tokë, përveç atyre që do Allahu (të mos vdesin), pastaj i fryhet atij herën tjetër, kur qe, të gjithë ata të ngritur e presin (urdhrin e Zotit)."

Katër: ringjallja: bëhet fjalë për ngjalljen e të vdekurve nga ana e Allahut, azze ve xhel, pasi t'i fryhet surit për së dyti. Atëherë njerëzit do të ngrihen prej varreve. Do të shpejtojnë të dalin në vendqëndrimin para Allahut. Do të jenë të zhveshur, këmbëzbathur, të pa bërë sunet dhe duarzbrazur. Ky qëndrim do të jetë një kohë të gjatë, dielli do të afrohet mbi kokat e njerëzve dhe do të shtohet nxehtësia e tij. Njerëzit do të fundosen në djersët e tyre, dikush deri në zogj të këmbëve, dikush deri në gjunjë, dikush deri në mes, dikush deri në gjoks, dikush fundoset i tëri.

Ringjallja është realitet që e argumenton sheriati, shqisat dhe mendja:

Sa i takon sheriati, ka shumë ajete dhe hadithe që flasin për këtë. Allahu, subhanehu ve tealë, thotë: "Thuaj: "Po, pasha Zotin tim, patjetër do të

ringjalleni", po ashtu thotë: "Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë.", po ashtu thotë: "Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: "Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur? Thuaj: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim."

Argumenti shqisor: Allahu, subhanehu ve tealë, ua bëri të mundur disa njerëzve në këtë botë që të shohin ringjalljen. Në kaptinën Bekare ka pesë shembuj për këtë gjë. Fjala është për popullin e Musait, alejhi selam, njeriun që e vranë Beni Israilët, njerëzit që dolën prej shtëpive të tyre për të ikur nga vdekja, personi që kaloi pranë fshatit dhe shpezët e Ibrahimit, alejhi selam.

Argumenti logjik:

1) Allahu, subhanehu ve tealë, e ka krijuar gjithësinë pa qenë, kurse ai që e ka krijuar diçka pa qenë edhe më lehtë mund ta rikthejë atë.

2) Toka mund të jetë e vdekur, pasi që bie shi ajo ngjallet, gjelbërohet dhe lulëzon. Ai që ka fuqi për ta ngjallë atë pasi ka vdekur ka fuqi që t'i ringjallë edhe njerëzit pasi të vdesin.

Pesë: tubimi, llogaria dhe dënimi apo shpërblimi: Besojmë se njerëzit do të tubohen dhe do të dalin përpara Allahut, për t'u pyetur, për të dhënë llogari dhe çdonjëri merr shpërblimin e vet. Allahu, subhanehu ve tealë, thotë: "dhe Ne i tubojmë ata e

nuk na mbetet asnjë prej tyre pa e tubuar.", "Kujt t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: "O ju, qe lexojeni librin tim!" Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time. Dhe ai atëherë është në një jetë të

Edhe trupi, sikundër shpirti, do ta përjetojnë dënimin apo shpërblimin në varr. Ndonjëherë, ky përjetim mund të jetë i veçantë për shpirtin. Dënimi do të jetë për të padrejtët, ndërsa shpërblimi për besimtarët e vërtetë.

kënaqshme.", "Ndërkaq, kujt i jepen librat e vet nga e majta e tij, ai thotë: "O i mjери unë, të mos më jepej fare libri im. Dhe të mos dija fare se çka është llogaria ime."

Me fjalën tubim nënkuptohet thirrja e njerëzve dhe tubimi i tyre në "meukif" vendqëndrim për të dhënë llogari. Dallimi mes tij dhe ringjalljes është se ringjallja ka për qëllim kthimin e shpirtave në trupa kurse tubimi është thirrja e njerëzve dhe tubimi i tyre në vendqëndrim.

Llogaria dhe shpërblimi: është fjala për momentin kur Allahu, subhanehu ve teal, do t'i ndalë para Vetes, do t'i njoftojë me veprat e tyre. Besimtarët e devotshëm do të japin llogari duke i ekspozuar veprat e tyre dhe duke e

Të parit që do të japin llogari ditën e kiametit është ummeti i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem. Në mesin e tyre do të jenë shtatëdhjetë mijë që do të hynë në xhenet pa llogari, as dënim për shkak të përkryerjes së besimit të tyre.

parë dhuntinë e Allahut, i Cili ua ka mbuluar mëkatet, i ka siguruar nga trishtimi i madh, atë ditë kur disa fytyra do të zbardhen e disa do të nxihen.

Përgënjeshtresit, ata që ia kishin kthyer shpinën fesë së Allahut, shumë vështirë do ta kenë gjatë dhënies së llogarisë.

Të parit që do të japin llogari ditën e kiametit është ummeti i Muhamedit, salallahu alejhi ve selem. Në mesin e tyre do të jenë shtatëdhjetë mijë që do të hynë në xhenet pa llogari, as dënim për shkak të përkryerjes së besimit të tyre. Për cilësitë e tyre Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "nuk kërkojnë që t'u bëhet rukje, nuk shërohen me djegie (kauterizim), nuk





parashikojnë të ardhmen me shenja dhe vetëm në Zotin e tyre mbështeten."

Puna e parë për të cilën njeriu do të jep llogari e që ka të bëjë me obligimet ndaj Allahut është namazi. Sa u takon obligimeve ndaj njerëzve, obligimi i parë për të cilin do të jepet llogari është gjaku.

Gjashtë: Hauzi (Haudi): besojmë në hauzin e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem. Ai është një hauz i madh dhe një burim i shenjtë. Burimin e ka prej Keutherit në Xhenet. Uji i tij është më i bardhë se qumështi, më i ftohtë se bora, më i ëmbël se mjalti, kurse era e tij është më e mirë se era e miskut. Është shumë i gjerë. Çdo kënd është larg nga këndi tjetër sa një muaj udhë-

tim. Enët e tij janë më shumë se yjet e qiellit. Ai që pi prej tij nuk etet më asnjëherë.

Shtatë: ndërmjetësimi (shefati): kur të vështirësohet gjendja në mahsher, të zgjatet qëndrimi, njerëzit do të nxitohen për të gjetur ndonjë ndërmjetësues që të shpëtojnë nga bregat dhe tmerri i atij qëndrimi. Do të drejtohen te pejgamberët e zgjedhur, mirëpo të gjithë do të arsyetohen se janë të preokupuar më çështjet e veta përpos Muhamedit, salallahu alejhi ve selem, vulës së pejgamberisë, të cilit Allahu ia ka falur të gjitha mëkatet. Ai do të bie në sexhde, nën arsh, dhe do ta falënderojë e lavdërojë Allahun me disa lutje që do t'ia mësojë Allahu, subhanehu ve teal.

Ky është ndërmjetësimi i madh me të cilin Allahu, subhanehu ve teal, do ta veçojë Muhamedin, salallahu alejhi ve selem. Ka edhe ndërmjetësime tjera:

1.ndërmjetësimi që xhenetlijeve t'u lejohet për të hyrë në Xhenet.

2.ndërmjetësimi për ata që i kanë të barabarta të mirat dhe të këqijat.

3.ndërmjetësimi për mëkatarët që e meritojnë zjarrin, për të mos hyrë në zjarr.

4.ndërmjetësimi për t'i ngritur gradët e banorëve të xhenetit.

5.ndërmjetësimi për disa njerëz që do të hyjnë në xhenet pa llogari.

6.ndërmjetësimi që të dalin mëkatarët të cilët kanë hyrë në zjarr,.


7.ndërmjetësimi për t'ua lehtësuar dënimin atyre që meritojnë dënimin siç është rasti me xhaxhain e Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, Ebu Talibin.

Prezantim i librit

"Studime dhe Fetva"

Shkruan: Bekir HALIMI

Titulli i librit: "Studime dhe Fetva"
 Mblodhi dhe përgatiti: Ismail Bardhoshi
 Botoi: Shtëpia botuese "Dy Lindje dhe dy Perëndime"
 Tiranë - 2006 Fq: 500



Libri në fjalë është hartim i disa teksteve dhe shkrimeve të imamëve të mëdhenj që nga koha e vjetër e deri më sot. Kjo i jep vlerën dhe rëndësinë këtij libri, të cilin jemi duke ua paraqitur në këtë shkrim.

Ky libër, duke u mbështetur në imamët e mëdhenj, sikurse është Ibën Tejmiu, Shatibiu, Ibën Kajimi, Albani, Ibën Bazi, Uthejmini, Abadi, komisioni i përhershëm për fetva, mëton të japë sqarime shumë të domosdoshme dhe jetësore për zhvillim të shëndoshë të këtij zgjimi të begatë islam të rinisë së popullit tonë të dashur shqiptar.

Si çdo zgjim, pasohet me veprime jo shumë mirë të balancuara, por vijon mungesa e koncentrimit të madh dhe mungesa e vizionit të qartë të asaj që dëshiron ta arrijë gjatë asaj dite; edhe zgjimi kolektiv i një populli, është shumë normal që në fillimin e këtij zgjimi t'i përjeton të njëjtat gjëra. Ky libër mundohet që njerëzve që janë duke e përjetuar këtë zgjim t'u japë ndihmë që mos ta vazhdojnë jetën pas zgjimit në mungesë të vizionit të qartë dhe të pastër e as në mungesë të balancimit të veprimeve të veta, duke anuar

herë në të majtë e më shumë herë në të djathtë.

Në hyrje të librit hartuesi e tregon qartë nevojën e këtij libri dhe synimin që ka, e ajo është "ta dijë se çfarë është bidat dhe çfarë nuk është i tillë, çfarë është kufër dhe çfarë jo, kush është bidatçi dhe kush nuk është bidatçi, kush është kafir dhe kush nuk është kafir". (fq. 18).

Ai, duke përmendur disa raste të keqkuptimit të qëndrimeve të dijetarëve dhe imamëve të njohur nga disa njerëz dhe etiketimi i tyre me lloj-lloj etiketimesh, i merr si bazë për të argumentuar se edhe sot ka këso njerëz, të cilët refuzojnë të studiojnë tërësinë e jetës shkencore dhe të veprimtarisë së një dijetari dhe shkencëtari, por i kapin ca fjalë dhe pjesë shkrimesh dhe në bazë të tyre i etiketojnë si të dalë nga rruga e Ehli sunnetit, gjë e cila ka ndodhur në të kaluarën dhe me kalimin e kohës është vërtetuar se është gabim dhe nëse ndodh në këtë kohë, me kalimin e kohës do të vërtetohet se është gabim, andaj rinia jonë islame nuk duhet të bëhet viktimë e këtyre luftimeve intelektuale dhe të bëhet pre i këtyre zënkave dhe mosmarrëveshjeve, të cilat lindin shumë dukuri negative, sikurse është mosrespektimi i dijetarëve, keqkuptimi i teksteve, mbështetja në deklarata të gjymtuara, nxitimi për të dhënë gjykime dhe vlerësime për fenomene, njerëz dhe organizma, diferencimi i njerëzve për mosmarrëveshje të vogla, përçarja e myslimanëve, mosnjohja e realitetit të myslimanëve nga populli i tyre, imponimi i çështjeve që nuk përkojnë me kapacitetin fetar të popullit të tyre, imponimi i luftërave ideologjike për të cilat populli ynë nuk është i përgatitur, mundësitë për keqpërdorim nga struktura të caktuara dashakeqe të Islamit dhe myslimanëve ndër popullin tonë etj. (shiko faqet: 20- 26).

Në fund të parathënies së tij ai i jep edhe

Në hyrje të librit hartuesi e tregon qartë nevojën e këtij libri dhe synimin që ka, e ajo është "ta dijë se çfarë është bidat dhe çfarë nuk është i tillë, çfarë është kufër dhe çfarë jo, kush është bidatçi dhe kush nuk është bidatçi, kush është kafir dhe kush nuk është kafir".

disa sqarime të rëndësishme, prej tyre do t'i paraqesim këto:

Leximi i librave të dijetarëve të njohur, sikurse është Shatibiu, Ibën Tejmju, Sad Gamidiu, Ibrahim Ruhejli që flasin për bidatin dhe bidatçitë.

Lufta ndaj bidatit dhe bidatçive është detyrë fetare, mirëpo jo keqpërdorim i këtyre rregullave për diskualifikim të thirrësve të

njohur në trevat tona dhe eliminim të konkurrencës.

Nuk duhet tu mvshen qëndrime të grupeve të caktuara, që sipas rrugës së Ehli Sunetit janë të gabuara, të gjithë thirrësve të Ehli Sunetit, me vet faktin se këta i heshtin për momentin gabimet e tyre.

Nuk duhet të mohohet mudi që është derdhur për pesëmbëdhjetë vjet në përhapjen e sunetit dhe njohjes së rrugës së Ehli Sunetit dhe nuk duhet dikush ta paraqet vetveten si restartues i rrugës së Ehli Sunetit.

Bashkëpunëtor me shkrimet dhe përkthimet e tyre të disa teksteve që gjenden në brendësinë e këtij libri janë: hoxha i njohur Ahmed Kalaja, Bilal Teqja, Azem Bardhoshi, Sajmir Ismaili dhe Bilal Shkrepi.

Ky libër përbëhet prej dhjetë krerëve.

Kreu i parë flet për Bidatin, kuptimi dhe përkufizimi i bidatit, ndarja e bidatit, kush cilësohet bidatçi, disa shenja të bidatçive dhe qëndrimi i Selefit ndaj bidatçinjve.

Kreu i dytë flet për pasimin e Sunetit, apo thënë ndryshe është paraqitje e shkrimit dhe libërthit të hoxhës së madh AbdulMuhsin Abadit, ish rektor i Universitetit Islamik në Medinë, i cili nëpërmjet këtij libri ka dashur t'i bëjë disa sqarime për fanatikët e etiketimeve dhe atyre që diskualifikojnë nga xhemati i Ehli Suneti njerëz për gabime shumë të vogla. Argument për këtë që them është nëntitul-

li "bidati i provimit të njerëzve për të nxjerr në shesh mendimet e tyre personale" dhe "Fitneja e "texhrihut" degradimit të njerëzve".

Kreu i tretë flet për Butësinë që duhet ta posedojë Ehli Suneti ndaj ithtarëve të Ehli Sunetit dhe ndaj tjerëve. Edhe ky kre përbehet nga një shkrim i hoxhës së lartpërmendur, i cili me këtë libër ka synuar të zbutë fitnen që ka ndodhur në botën islame me ashpërsinë dhe vrazhdësinë e etektimeve dhe diskualifikimeve të dijetarëve nga radhët e Ehli Sunetit për gjëra shumë të imta.

Kreu i katër flet për "Hexhrin", injorimin dhe izolimin e bidatçive dhe mëkatarëve duke u mbështetur në sqarimet e shejhlul Islam Ibën Tejmiut.

Kreu i pestë flet për rregullat e tekfirit (anatemosjes), e cila është dukuri paralele me atë të parën, tebdium (vlerësimin e njerëzve si bidatçi). Këtu i sqaron kushtet e tekfirit dhe pengesat e tij.

Kreu i gjashtë është paraqitje e një shkrimit të muhadithit më të madh bashkëkohor dhe me origjinë shqiptare, Muhamed Nasirudin Albanit, me titull "Kush është kafir dhe kush bidatçi".

Kreu i shtatë flet për Metodën e Ehli Sunetit në argumentim dhe referim. I paraqet disa parime të argumentimit dhe analizë të disa fenomeneve shkencore, sikurse është argumentimi me hadithe ahad, pozita e logjikës në Islam, etj.

Kreu i tetë flet për Xhematin e vërtetë, emri dhe metoda e davetit të këtij xhemati. Pastaj flet për metodat e gabuara të xhemateve tjera dhe qëndrimi i muslimanëve ndaj tyre. Nxijtja për bashkim, dënimi i përçarjes dhe sqarimi i llojeve të mosmarrëveshjeve. Këtu ka sqarime rreth domethënies së Ehli Sunetit, Selefizmit,

Grupit të Shpëtuar (El-Firkatun-Naxhije), Palës së Ndihtuar (Et-Taifetul-Mensure), Ehlu Hadithit, mbi parimin "dëlirje dhe edukim", detyrimi i gjykimit me shariat, rreth xhihadit, rregullat e bashkëpunimit me xhematët tjerë, provokimi i njerëzve, pozita e dijetarëve në Islam, kritikata mes thirrësve, gëzimi me gabimin e tjerëve, legalizimi i gëbetit (përvojimit) në emër të "xherhit", mbi metodën e krahasimit të të mirave dhe gabimeve të një dijetari dhe çështjet që kanë të bëjnë me përngjasimin.

Kreu i nëntë flet për Thirrjen dhe mënyrat dhe mjetet e thirrjes në fe të Allahut. Këshillat e Ibën Uthejmunit, Ibën Tejmiut dhe Albanit për ata që thërrasin në fe të Allahut. Parimi i vlerësimit të parimit të dëmit dhe dobisë. Nevoja për mëshirë, durim dhe tolerancë gjatë procesit të thirrjes. Premtimet dhe kërcënimet si metodë Kur'anore për thirrje në fe të Allahut.

Kreu i dhjetë flet për Rregullat Islame për trajtim të fitmeve dhe trazirave dhe me këtë kre përmbillet ky libër.

Kompiluesi i këtij libri Ismail Bardhoshi ka kryer fakultetin islamik në Universitetin e Imam Muhamed Ibën Suudit në Rijad, kurse studimet postdiplomike i vazhdon në Universitetin Amerikan të hapur me seli në Kairo. Është i njohur për mësimet dhe ligjëratat e tija që i mbanë anëmbanë Shqipërisë dhe në trojet tjera shqiptare.

Mendoj se ky hap ka qenë shumë i qëlluar dhe i bereqetshëm nga vëllai ynë, i cili me këtë kontribut ka manifestuar akademizmin e tij dhe brengën për të mbrojtur këtë zgjim të bekuar islam nga çdo lloj devijimi, sado që në fillim mund të jetë i vogël.

E lusim Allahun, azze ve xhel-le, ta shpërblejë me shpërblimet e Tijta të mëdha dhe ta inspurojë që të na freskojë herë pas here me këso veprash. Amin.

Rinia jonë islame nuk duhet të bëhet viktimë e këtyre luftimeve intelektuale dhe të bëhet pre i këtyre zënkave dhe mosmarrëveshjeve, të cilat lindin shumë dukuri negative, sikurse është mosrespektimi i dijetarëve, keqkuptimi i teksteve

E lusim Allahun qe te jeni mire...

Allahu ju shpërbleftë, revista juaj është me e mira dhe prej se e njoh këtë revistë, e kam lexuar vazhdimisht, ndërsa temat më të nevojshme i kam lexuar nga 2-3 here e me shume. Nuk kam asnjë vërejtje për revistën ndërsa për te rejat qe do te i bëni po e shprehi edhe unë mendimin tim... për dizajn te ri nuk ka problem por qe te jete me i shitur mundohuni qe dhe çmimin ta ketë sa me te ulte. Po ashtu, nëse mundeni se paku pasi te shtypet albislam temat te dalin edhe ne internet qe te lexohen nga ata qe nuk e blejnë se është shume revistë e mire dhe ka tema shumë te mira...

Besoi se me kuptuat, Allahu ju shpërbleftë për mirëkuptimin...

Kasim Jakupi

Të nderuar miq!

Duke e lutur Allahun qe t'ju japi bereqetet e Tij ne te dy dunjate, dua T'ju dërgoj një ide qe e kam menduar në lidhje me risitë e revistës tone, Albislam, me shprese te mirëkuptimit nga ana e juaj (redaksisë)...

Kam menduar qe ne kuadër te revistës te behet një shtojce ku i takon te Vegjëlve - fëmijëve ... te ketë shume pake fleta, po ato fleta ne vete të përmbajnë një karakter të lartë këshillues e joshës për fëmijët , si dhe këshilla te dobishme rreth tyre; se si ata të jenë të sjellshëm dhe të edukuar denjësisht.

Kjo është në favor të revistës, kurse në te të punohet me kujdes... kjo është çka unë e kam menduar, nëse juve ju duket e arsyeshme vazhdoni e punoni në këtë drejtim...

*Allahu ju pastë në emanetin e Tij .
me nderime:Valbona Kelmendi*